UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA

‘’ KUJDESTARIA NDAJ FËMIJËVE TË MITUR SIPAS LEGJISLACIONIT FAMILJAR TË RMV-së ‘’

Kandidati: Mentori:

Albina Ibraimi Prof. dr. Arta Selmani Bakiu

TETOVË, 2023

DEKLARATA E AUTORSISË

Unë Albina Ibraimi, deklaroj nën përgjgjësinë time të plotë se ky punim është bërë personalisht nga unë nën mbështetjet burimeve të informacioneve, librave si dhe materialeve të gjetura në webfaqe dhe me ndihmën e resurseve të ndryshme.

Të gjitha materialet e lartpërmendura janë, realizuar duke iu referuar dhe duke i përdorur në formë të fusnotave.

FALINMINDERIME DHE MIRËNJOHJE

Të jesh pjesë e Ciklit të dytë të studimeve në programin studimor të së Drejtës Civile,pranë fakultetit UEJL-së nuk është edhe lehtë për mua si studente e re.Megjithatë, gjatë rrugtimit tim, të gjithë profesorët me bashpunimIn e ndërsjellt profesor-student, pozitivitetin si dhe mbështetjen e tyre më ndihmoi që mos të ndjehem e huaj në atë mes.Prandaj, shpreh faliminderimet e mija ndaj të gjithve.

Duke marrurr parasysh këtë ditë të rëndësishme, gjej rastin të shtprej faliminderimet dhe mirënjohjet e mija, për të gjithë ata të cilët gjatë këtij procesi të hulumtimit më mbështën si dhë më dhanë shtytje që të vazhoj kërkimin pavarësisht sfidave.

Posaçërisht dua t'i shpreh faliminderimet e mia mentores sime, Doc.dr. Arta- Selmani Bakiu, e cila gjatë tërë këtij rrugëtimi, mu gjend pranë duke më motivuar dhe ndihmuar për të realizuar procesin kërkimor.

Në mënyrë të veçant faliminderoj familjen time, me mbështetjen dhe përkrahjen e tyre arrita deri në këtë fazë.U jamë mirënjohëse pafund prindërve të mi të cilët më bënë të besoj se mund t'ia dal të arrij deri ktu.

Gjithashtu, në mënyrë të veçant faliminderoj motren time Albulena Ibraimi, e cila pafund besoi në aftësitë e mija dhe në çdo moment më motivoi, po ashtu e faliminderoj edhe për durimin që tregoi për ankesat e mija gjatë këtij rrugëtimi.

Ju falemderit të gjithve !

SHKURTESA

QPS-Qendra për Punë Sociale

MPB-Ministria e Punëve të Brendshme

CRC-Convention on the Right of the Child

CRPD- Convention on protection of the right of persons with dissabilities

CEDAW-Convention on Elimination of Discrimination Against Woman

HYRJE

1.LËNDA E HULUMTIMIT
2.QËLLIMI I HULUMTIMIT
3.HIPOTEZAT
4.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT
5.RËNDËSIA E HULUMTIMIT

1. Lënda e hulumtimit

Lënda e këtij hulumtimi është kujdestaria e femijëve të mitur në RMV. Në fokus do të jetë Legjislacioni i së drejtës Familjare i cili e rregullon kujdestarinë i rregulluar sipas Ligjit për Familjen të RMV-së, sipas dispozitave të të cilit shteti iu ofron ndihmë të veçantë fëmijëve të mitur, fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, personave madhorë të cilëve i'u është hequr ose kufizuar aftësia për të vepruar si dhe sigurimi i kujdestarisë në raste të veçanta. Gjithashtu do të analizohen edhe Konventat Ndërkombëtare përmes të cilave rregullohet ky institut. Gjithashtu institucioni i kujdestarisë do të analizohet edhe përmes praktikës juridike, duke u bazuar në praktikën gjyqësore, raportet dhe rekomandimet e sjella nga Avokati i Popullit. Kujdes të veçantë do ti kushtohet praktikës së Qendrave për Punë dhe Politikë Sociale dhe fushëveprimit të tyre në rastet e ushtrimit të funksionit të kujdestarisë si dhe vendosjen e kujdestarit për të gjitha rastet për të cilat nevojitet kjo masë juridike- familjare për mbrojtjen e kategorive të caktuara personave.

2. Qëllimet e hulumtimit

Një ndër qëllimet kryesore të këtij hulumtimi është analiza e aplikimit të Ligjit për Familjen në rastet e braktisjes së fëmijeve nga prindërit nga pamundësia e ofrimit të kujdesit ndaj tyre. Koncepti i kujdestarisë paraqet bazën e këtij punimi, institucion ky i cili vë në pah kujdesin e shtetit dhe shoqërisë duke aplikur mekanizmat mbrojtës dhe funksional konform ligjit ndaj personave të cilët për arsye të ndryshme nuk janë në gjendje të kujdesen ndaj vetes së tyre si dhe të për drejtat dhe interesat e tyre. Statistikat nga Qendra për Punë dhe Politikë Sociale dhe nga Avokati i Popullit do të na mundësoj interpretim të rasteve të vendosjes së kujdestarisë. Fakti që shtjellomë çështje të fëmijëve e dijmë që bëjnë pjesë në atë grup të njerëzve ku nuk kanë pjekurin mendore dhe emocionale sikur të rriturit për të shprehur dëshirat dhe nevojat e tyre, kështu që fëmija ngelet qenia më e pambrojtur në shumë aspekte. Një ndër qëllimet tjera, që duam të theksojmë është se se çdo fëmijë në botë pavarisisht moshës, gjinis, racës, kombit dhe religjionit meriton të ketë kushtet bazike jetësore, siç janë: e drejta për kujdes, mirëmbajtje, për ushqim, veshmbathje, të drejtën e arsimit; të drejta këto të garantaura me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

3. Hipotezat

Hipotezat që do të parashtrohen në këtë punim janë:

Hipoteza e parë: Analizë e masave mbrojtëse të shqiptuara nga Qendra për Punë dhe Politikë Sociale. A kanë qendrat tona Sociale kapacitet për ti trajtuar të gjitha rastet të cilat duhet të vendosen nën kujdestari, cilët janë masat që ata ndërmarin si dhe aspekte tjera të analizimit të fushëveprimit të Qendrave për Punë dhe Politikë Sociale.

Hipoteza e dytë: Nga të gjithë kategoritë e personave që duhet të vendosen nën kujdestari, kujdes të veçantë do të ju kushtohet fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore si kategori më e pambrojtur e shoqërisë. Qendrat për Punë Sociale, a kanë trajtim të veçantë kur vendosin për kujdestarinë e këtyre fëmijëve? Analizë komparative për të marrë si rekomandim vendosjen e fëmijëve nën kujdestari.

4. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë disertacion të magjistraturës do të përdoren këto metodat hulumtuese:

Metoda juridike- do të analizohen dispozitat ligjore mbi institucionin e kujdestarisë.

Metoda historike- do të jepet pasyqyrë historike mbi institucionin e kujderstarisë së fëmijëve.

Metoda e intervistimit dhe metodat statistikore.

5. Rëndesia e punimit

Ky punim do të vë në pah zbatueshmërinë e dispozitave të Ligjit për Familjen lidhur me vendosjen nën kujdestari të fëmijëve dhe personave të cilëve iu është kufizuar apo hequr aftësia e veprimit, veprimin e organeve shtetërore për ofrimin e mbrojtjes juridike-familjare të kësaj kategorie të pambrojtur të shoqërisë.

Do të jepen analiza mbi këtë insitucion të së drejtës familjare të nxjerr nga e drejta komparative si dhe nga zbatueshmëria e të drejtës ndërkombëtare, të konventave të ratifkuara të RMV-së e të cilat rregullojnë ofrimin e mbrojtjes juridike fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore. Duke marrë parasysh se bërthama e një shoqërie pikërisht qëndron te fëmijët dhe se e ardhmja e një shoqërie të shëndoshë konsiston në rritjen e dinjitetshme të fëmijëve, është fundamentale që pavarsisht zbrastirës ligjore, ligji të aplikohet në tërësi.

PËRMBAJTJA

1. STRUKTURA E KORNIZËS LIGJORE PËR KUJDESTARI NË RMV

1.1. Kujdestaria si institucion – kuptimi dhe objekti i saj.....10

1.2. Rregullimi juridik i kujdestarisë-Parimet.....12

1.3. Qendra për Punë Sociale.....14

1.4. Kompetencat e Organit të Kujdestarisë.....16

1.5. Kujdestari.....18

1.6. Pushimi i kujdestarisë.....20

2. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E KUJDESTARIT

2.1. Obligimet e kujdestarit.....22

2.2. Të drejtat e kujdestarit 23

2.3. Përgjegjësia e kujdestarit 24

3. LLOJET E KUJDESTARISË

3.1. Kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur –Arsyet e vendosjes nën kujdestari 26

3.2. Autorizimet dhe obligimet e kujdestarit 29

3.3. Pushimi I kujdestarisë ndaj fëmijëve të mitur.....31

3.4. Kujdestaria ndaj personave të cilëve i'u është hequr ose kufizuar aftësia për të vepruar.....32

3.5. Autorizimet dhe obligimet e kujdestarit të personit të cilit i është hequr aftësia e veprimit- arsyja e vendosjes në kujdestari të personit madhorë.....33

3.6. Pushimi i kujdestarisë ndaj personit të cilit i është hequr plotësisht aftësia për të veprruar.....34

4. KUJDESTARIA PËR RASTE TË VEÇANTA

4.1. Kujdestaria e personave me vendbanim të panjohur 37

4.2. Kujdestari i pasurisë të cilit nuk i dihet pronari.....38

4.3. Kujdestaria për shtetas të huaj.....39

4.4. Kujdestaria ndaj personave të mitur viktima të trafikimit me njerëz……40

5. RASTE TË TJERA TË KUJDESTARISË

5.1. Kujdestaria sipas këndvështrimit të Praktikës Gjyqësore Evropjane për të drejtat e fëmiut……44

5.2. Vështrim historik mbi të drejtat e fëmijëve……47

5.3. Trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar……50

5.4. Studim rastesh……53

5.5. Statistika rreth studime rastesh……55

5.6. Roli I Avokatit të Popullit në mbrojtjrn e të drejtave të fëmijëve……59

5.7. Rezultate nga anketa mbi kujdestarinë e fëmijëve të mitur në RMV……62

6.KONKLUZIONE ……75

7. BIBLIOGRAFIA ……76

8.Bibliografia……77

7. Përfundimi

Konsideruar jetën, dinjitetin, interesin, zhvillimin e mirëqënë të fëmijeve, si vlera fundamentale si dhe parimeve bazë referuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijeve, Institucionit të Kujdestarisë, Kujdestarit si autorizues në mbrojtejen e të drejtave dhe interesave personale të po këtyre personave të vendosur nën kujdestari, hulumtimet e rasteve si dhe hulumtimi në tërësi do të përpiqemi t'i vërtetojmë hipotezat e parashtruara.

Gjithashtu, konsiderojmë që në pjesën përfundimtare, nga rezultatet e fituara nga hulumtimi teorik dhe praktik, do të arrijmë të japim rekomandime dhe përfundime konkrete, me qëllim të aplikimit sa më dinjitoz të institucionit të kujdestarisë dhe ofrimin e mbrojtjes së nevojshme për të gjitha personat nevojtarë.

Përmbledhje

Faktorët thelbësorë si kujdesi, zhvillimi, edukimi dhe mirëqenia e fëmijës konceptohen si themelet fundamentale, të cilat përfaqësojnë interesin dhe mbrojtjen më të lartë të qenieve më të pambrojtura në një shoqëri.

Mospjekuria emocionale dhe mendore në krahasim me të rriturit dhe brishtësia karakterstike janë elementet bazë, të cilat definojnë të miturit. Shkaktarë të cilët janë determinues deri në pamundesinë fizike e mendore për përkujdesje ndaj vetvetes dhe intereseva të tyre, si ambijent më i përshtatshëm dhe më i ngrohtë në ofrimin e ketyre shërbimeve dhe mbi të gjitha, mbrojtja më e sigurtë do të llogaritej familja. Ajo, si institucion i cili mbartë në vete të drejtat dhe detyrimet përkatese për rritjen, zhvillimin dhe përkujdesjen ndaj fëmisë në RMV, jo gjithmonë fëmijeve do t'u diktohej mundësia për t'i gëzuar këto të drejta për shkak të rrethanave dhe fatkorëve të ndryshëm si: neglizhenca nga ana e prindërve (mos ushtrimi i detyrimeve në pajtueshmëri me Ligjin për përkujdesje sipas legjislacionit familjar të vendit), varfëria, mirëqenia sociale jo në nivel të duhur, pamundësojnë mbrojten e po këtyre të drejtave dhe detyrimeve, etj.

Nga pamundësia e realizimit të përgjegjësive dhe detyrimeve të lartëpërmendura prindërore shteti ka paraparë alternativë tjetër në mbrojtjen e tyre i cili përmes Ligjislacionit familjar rregullon kujdestarinë neni 124, "Me kujdestari shteti u jep mbrojtje të veçantë fëmijeve të mitur të cilët janë pa kujdesje prindërore si dhe personave madhore të cilëve u është marrurr apo kufizuar aftësia për të vepruar".

Fjalët kyçe: Fëmijet e mitur, Kujdestaria, Ligji për familje, Qendra për punë sociale.

KAPITULLI I PARË: STRUKTURA E KORNIZËS LIGJORE PËR KUJDESTARI NË RMV

1.1. Kujdestaria si institucion, kuptimi dhe objekti i saj

Në korpusin e çdo shteti parim bazë është mbrojtja e lirive, të drejtave dhe dinjiteti njerëzor, nga edhe burojnë dokumente ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve të cilat janë të karakterit të rëndësishëm në mbrojtjen e personalitet dhe interesit të fëmijës.

Një ndër ata është edhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve, i cili jep rëndësi subjektivitetit të femijës dhe e trajton si qenie me nevoja të veçanta ku dhe vlerëson jetën e tij si të patjetërsueshme. Kjo Konventë kujdesin ndaj fëmijëve e koncepton si një ndër vlerat themelore në ofrimin e kësaj mbrojtje, si dhe obligon çdo shtet me oraganet apo institucionet e saj kur ky obligim nuk mund të realizohet nga prindërit ndaj fëmijeve të tyre.[1]

Kur jemi tek RMV, mbrojtjen e fëmijës e fokuson në legjislacionin e saj nacional përmes ligjit për familje, e cila në bazë të dispozitave të saj rregullon Institutin e Kujdestarisë si dhe duke aplikuar gjithashtu sistemin e mbrojtjes sociale.

Familja pretendohet të jetë gjithmonë bërthama dhe ambienti më i rëndësishëm, ku femijëve mund t'u sigurohet mbështetje në zhvillimin e personalitetit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave te tyre. Këto vlerësohen të jenë ndër faktorët shtyse për një jetë më cilësore dhe të dinjitetshme të fëmijës, pasi që fëmijëria e hershme konsiderohet të jetë fazë mjaft domethënëse dhe në të njejtën kohë e rendësishme për zhvillimin e mirëqenë të tyre .

[1] Zendeli, E., Selmani - Bakiu, A., Mickovic, D., Ristov, A., (2020). "*E drejta familjare"* Tetovë, f.215

Por, në të shumtën e rasteve për shkak të rrethanave të ndryshme siç mund të jenë varfëria, papunësia, prindërit nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre prindërore ose në rastet kur fëmijet janë të privuar nga kujdesi prindëror ose keqtrajtohen. Në situata të tilla shteti detyrohet të aplikojë alternativë tjetër në mbrojtjen e fëmijeve me vendosjen e tyre nën kujdestari.[2]

Duke u nisur që nga Kushtetuta si akt më i lartë juridik i RMV-së mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut siguron mbrojtje dhe kujdes të veçantë familjes. Mirëpo, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një kategori më komplekse dhe konsiderohet të jetë fushë më e gjërë.

Korniza tekstuale ligjore për familje përmes institutit të Kujdestarisë neni 124, paragrafi 1 thotë: U ofrohet mbrojtje e veçantë fëmijëve të mitur pa kujdes prindëror dhe personave madhorë të cilëve u është marrë, apo kufizuar aftësia e veprimit. Po ashtu edhe sipas dispozitave të këtij ligji "mbrojtje u ofrohet edhe personave të tjerë të cilët nuk janë në gjendje ose nuk kanë mundësi vet të kujdesen për të drejtat dhe interesat e veta".

Kur jemi te Ligji për familje, në ndejtim të mbrojtjes së te drejtave të femijëve si dhe familjes, amësisë, fëmijëve të mitur, femijëve të mitur pa prindër dhe pa kujdes prindëror,shteti u ofron mbrojtje të vecant, i cili këtë detyrë e realizon përmes kujdestarisë , formë e cila kryesisht shërben në mbrojtjen e këtyre fëmijëve.[3]

Nëvojën për të vënë nën kujdestari fëmijën Qendra për Punë Sociale e aplikon duke vlerësuar dhe ndërrmarrë masat e duhura dhe gjithmonë duke u udhëzuar nga interesi më i lartë i fëmijës.

Për t'u përmbledhur qëllimi i zbatimit të instucionit të kujdestarisë është vënja e personave të mitur nën kujdestari, të cilët janë të privuar nga kujdesi prindëror, personat madhorë të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre si dhe zbatimi i masave të nevojshme dhe efikasiteti gjatë dhe pas vendosjes .

---

[2] Melo. I., LL.M, (2009). " *Shërbimi i kujdestarisë ndaj të miturve jashtë kujdesit prindërore dhe roli i shtetit shqiptar"*, Revista shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV , instituti Alb-Shkenca.

[3] *Посебен извештај за состојбата и условите за остварување на правата на децата без родители и родителска грижа сместени во јавните Установи за грижа во Република Македонија*,(2017), Скопје, Декемри, стр.3

1.2. Rregullimi juridik i kujdestarisë - parimet

Ligji për Familje e rregullon kujdestarinë duke u nisur sipas disa parimeve bazë të cilat gjenezën e kanë nga Kushtetuta dhe Ligji.

Ligji taksativisht i numëron këto parime:

Sipas parimit të natyrës shoqërore të kujdestarisë - e drejta e kujdestarisë konceptohet si institut i karakterit të rëndësishem shoqëror. Kjo lë te nënkuptohet që në të kaluarën kujdesi ndaj personave të cilët e kanë pasur atë nevojë për mbrojtje është ofruar brenda familjes. Me kalimin e kohës, edhe shteti përfshihet në këtë drejtim. Në ditët e sotme, sipas të drejtës familjare, kujdesi ndaj personave të cilët kanë nevojë për atë mbrojtje, ofrohet nga Organi i Kujdestarisë, andaj, vimë në përfundim se kjo cilësohet si mbrojtje e karakterit të natyrës shoqërore.

Parimi i mbrojtjes së veçantë shoqërore të personave të vendosur nën kujdestari - ky parim ka të bëjë me raportin e shtetit dhe institucionit të kujdestarisë adresuar fëmijëve të mitur, formë e cila është në shërbimin e jnevojave si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, të cilët gjenden në pozita të e pafavorshme nga privimi i të kujdesurit nga prindërit e tyre.

Parimi i mbrojtjes prioritare të personalitetit të përkujdesurit - Specificiteti i këtij parimi ka të bëjë me rëndësinë primare nga ana kujdestarit ndaj personalitetit të përkujdesurit - të miturit, kur themi personalietetin përveç tjerash kjo në vete ngërthen kujdesin ndaj pasurisë si dhe interesave ekonomike të tij. Gjithashtu, kjo përshkruan edhe raportin si dhe obligimet e kujdestarit ndaj të të miturit për personalitetin ejb të cilit duhet të kujdeset si të ishte prindi i tij e posaçërisht për edukimin, arsimimin si dhe aftësimin e tij për një jetë të pavarur.[4]

[4] Zendeli, E., Selmani-Bakiu, A., Mickovic, D., Ristov, A., (2020) "*E drejta Familjare*", Tetovë, f. 302

Kurse kur jemi tek Konventa për të Drejtat e Fëmijeve, parimet bazë që i vënë themelin të drejtave të fëmisë renditen si më poshtë:

1. Mosdiskriminimi
2. Interesi më i lartë i fëmijës
3. E drejta për jetë dhe zhvillim
4. E drejta për tu dëgjuar

Universaliteti i këtyre parimeve ishte i hartuar në mënyrë të njëanshme nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, ku u njihej gjithëpërfshirja. Nga karakteri i tyre gjithëpërfshirës Komiteti e shihte si të arsyeshme të shihen si parime gjenerale te Konventës. Dhe vlen të theksohet se që në atë kohë gjeneraliteti i parimeve ka mbetur i një rëndësie të madhe që në dizajnimin e tyre. Parimit të mosdiskriminimit dhe të drejtës për jetë u është njohur në mënyrë absolute e drejta fundamentale, andaj nuk është ndjerë nevoja për t'i vlerësuar.[5]Kurse, kur jemi tek interesi më i lartë i fëmijës në kontekstin e të drejtave të njeriut, cilësohet si parim i veçantë që i kushtohet të drejtës së fëmijës.

E drejta për t'u dëgjuar gjithashtu është një ndër parimet me peshë pasi që luan rol të veçantë në rrethana specifike, e sidomos në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve si në çdo procedurë juridike dhe administrative që ka të bëjë drejtpërdrejt me fëmijën.

[5] www.cursera.org, *"children's human rights-an interdisciplinary introduction"*,(2022),University of Geneva

1.3. Qendra për Punë Sociale

Roli dhe qëllimi i Organit të Kujdestarisë është në ofrimin e mbrojtes së personalitetit, të drejtave dhe interesave të tyre, kur për arsye të ndryshme mund të vij deri te mosushtrimi i drejtë i së drejtës prindërore si dhe në çdo mënyrë tjetër nga e cila mund të cënohet jeta dhe dinjiteti i fëmisë. Për këtë arsye Ligji përmes Institutit të Kujdesatarisë në nenin 126, paragrafi 2 thotë: "Qendra për Punë Sociale ndërrmerr masa të duhura për realizimin e qëllimit të kujdestarise".[6]

Bazuar në këtë që u potencua, Qendra i vë në aplikim këto masa përmes punëve së saj që i kryen në mënyrë të drejpërdrejtë nëpermjet kujdestarëve, të cilët i realizojnë punët lidhur me kujdestarinë. Organi i kujdestarisë gjatë vënies së fëmijës nën kujdestari si dhe gjatë sjelljes së aktvendimeve të saja, ose masave që i ndërrmerr në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijës zbaton forma të mbrojtjes sociale dhe punë të tjera profesionale, gjithashtu aplikon edhe shërbimet e tjera sociale sic janë arsimimi, edukimi dhe shërbimet shëndetësore.[7]

Qëllimi i zbatimit të këtyre masave nga ana e institutit të Kujdestarisë është në mbrojten sa më efikase të të drejtave dhe interesave të këtyre personave të cilët kanë nevojë për atë mbrojtje. Kjo realizohet gjithmonë duke u udhëhequr nga interesi më i lartë i fëmijës. Për më shume, detyrimet dhe obligimet e saj i realizon përmes ekipit të tij profesional sic janë: pedagogët, psikologët, juristët dhe punëtorët social.

Po ashtu për të realizuar dhënien e shërbimeve sociale, si dhe mbrojtjen sociale ndaj fëmijëve dhe kategorive tjera socile themelohen institucione publike dhe private për mbrojtje sociale.

Mbrojten institucionale e kryejnë:

---

[6](" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"), LIgji për Familje,nr.153 nga 20.10.2014

[7] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A , Mickovic, D.,Ristov,A. "*E drejta Familjare*", Tetovë 2020 , f.303

- institucionet për akomodimin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël pa prindër dhe kujdes prindëror deri në moshën tre vjetë;
- institucione për akomodimin e fëmijëve pa prind dhe kujdes prindëror të moshës mbi tre vjet dhe për të rriturit;
- institucione për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukative-sociale;
- institucione për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me sjellje problematike;
- institucione për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me pengesa të vogla dhe të rënda të zhvillimit mental;
- institucione për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me pengesa në zhvillimin trupor;
- institucione për akomodimin e personave të moshuar;
- institucione për akomodimin e personave të rritur me pengesa trupore;
- institucione për akomodimin e personave me pengesa në zhvillimin mental dhe
- institucione për akomodimin e personave që kërkojnë të drejtën e azilit.[8]

[8] Institucione për mbrojtje sociale , https://www.mtsp.gov.mk/institucione.nspx

1.4. Kompetencat e organit të kujdestarisë

Kompetenca ka të bëjë me veprimtaritë e saja, të cilat i realizon Qendra për Punë Sociale, pavarësisht asaj se ku gjendet territori i atij personi qoftë sipas vendbanimit, ose vendqëndrimit të fëmijës, i cili vihet nën kujdestari. Qendra në kuadër të fushëveprimit të saj bën pjesë në sektorin e Punëve dhe Politikës Sociale, e cila sipas kornizave ligjore të saj funksionon si institucion profesional me kompetenca publike për realizimin e mbrojtjes sociale.[9]

Në kuadër të së drejtës, Organi i Kujdestarisë disponon me autorizime dhe kompetenca të cilat i përmbush në fushën e të drejtës së kujdestarisë si dhe në pjesë tjera të së drejtës familjare. Nën kompetencat e organit, në fushën e të drejtës së kujdestarisë bien punët të cilat ajo i realizon siç janë:

1. Punë të drejtpërdrejta

2. Punë udhëheqëse

3. Punë në mbikqyrje dhe ndihmë

Punët e drejtpërdrejta cilësohen punët dhe aktivitetet të cilat i kryen organi i kujdestarisë në funksionin e kujdestarit pa mos i caktuar kujdestar të veçantë të përkujdesurit. Kur jemi tek punët udhëheqëse, si të tilla konsiderohen: vënia e një personi në kujdestari, emërimi, ose shkarkimi i kujdestarit, sjellja e vendimit për vëllimin e autorizimeve të kujdestarit, vendosja për të drejtat dhe interesat e të mbrojturit, shpërblimi i kujdestarit dhe pushimi i kujdestarisë.[10] Kurse, në cilësinë e punëve mbikqyrëse dhe ndihmëse, organi i kujdestarisë përshkruan mënyrën dhe rolin e funksionimit të kujdestrisë në ofrimin e mbrojtjes së interesave të mbrojtësit. Analizuar në tërësi, kjo nënkupton se Qendra për Punë Sociale për realizimin e këtyre masave si dhe sjelljen e vendimeve të saja, zbaton forma të mbrojtjes sociale, metoda të punës sociale dhe

[9] mtsp.gov.mk ,Kompetencat e Qendrave për Punë Sociale
[10] Spiroviq-Trpenovska,L., Mickoviq,D., Ristov.A., (2013), "*E drejta Familjare*" Shkup, f.261

punës tjetër profesionale, si dhe mund të aplikojë gjithashtu edhe shërbimet e tjera të institucioneve sociale, shëndetësore, edukativo -arsimore dhe institucioneve të tjera. Po ashtu, Organi i Kujdestarisë ka një numër të konsiderueshëm konpetencash në pjesët tjera të së drejtës familjare si shembull kemi të drejtën martesore, në drejtim të së cilës jep mendim dhe këshilla në procedurën për dhënien e lejes së lidhjes së martesës, në fushën e së drejtës martesore ku merr pjesë në pajtimin e bashkëshortëve.

Në fushën e së drejtës prindërore, para organit të kujdestarisë realizohet procedura për njohjen e atësisë jashtëmartesore i cili vepron në cilësinë e palës në kontestet lidhur me amësinë dhe atësisë, ushtron mbikqyrjen e së drejtës prindërore, paraqet propozim për heqjen dhe kthimin e të së drejtës prindërore.[11]

Në rastet kur Oragani i Kujdestarisë mëson faktin se ndonjë person duhet të vendoset nën kujdestari, ai ka për detyrë që menjëhere të vë në aplikim procedurën e vendosjes nën kujdestari kundrejt personit të atillë. Në të drejtën tonë, sipas Ligjit për familje procedura për vënien nën kujdestari, realizohet sipas detyrës zyrtare ose personat e interesuar, procedurë e cila është urgjente (neni 127).[12]

Për të realizuar nevojën e vendosjes së ndonjë personi të caktuar nën kujdestari, ligjvënësi paraprakisht parasheh obligimin që organi në formë zyrtare të informohet nga: 1. ofiqari i gjendjes civile dhe organet shtetërore kur nga kryerja e punës së tyre duke u bazuar në kompetencat që i posedojnë do të kuptojnë se ekziston ndonjë rast i tillë, 2. të afërmit e familjes dhe fqinjët, 3. ndërrmarrjet, institutet bashkësitë vendore dhe organizatat dhe bashkësitë e tjera.

Duke marrur për bazë të gjitha fektet e lartpërmendura, nëse e sheh të arsyeshme vendosjen e fëmijës së mitur nën kujdestari, organi menjëher aplikon të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të personit të tillë duke inicuar procedurën për vendosjen nën kujdestari. Mbrojtja e tillë realizohet duke u udhëhequr nga parimi i interesave më të larta të të përkujdesurit si dhe konform interesave familjare të tij si dhe nga mundesitë materiale, nga çka në përmbushjen i këtij obligimi organi bashkpunon me organizat dhe institucionet e duhura.

---

[11] Spiroviq-Trpenovka, L., Mickoviq, D., Ristov A . (2013)''*E drejta Familjare* ' Shkup, f. 264

[12] (''Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë''), Ligji për familje, nr.127 nga 20.10.2014

Në Pajtim me Ligjin për familje vendosjen e personit të tillë, Qendra për Punë Sociale e informon ofiqarin në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

1.5. Kujdestari

Ligji për familje nuk ka dhënë ndonjë definim, apo ndonjë kuptim më adekuat mbi kujdestarin, por atë e konsideron si person të cilin e emëron dhe autorizon, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe i cili duhet të kujdeset për të drejtat personale dhe interesat pasurore të personit, i cili ka nevojë për atë kujdesje .

Roli dhe funksioni i kujdestarit ka rëndësi të konsiderueshme pasi që të gjitha punët dhe veprimet të cilat janë nën përgjegjësinë dhe kompetencën e organit të kujdestarisë, realizohen nga ana e kujdestarit. E mbi të gjitha se si do ti realizojë këto detyrime, gjithmonë vlerësohet nga fakti se si do të ofrojë këtë mbrojtje duke u bazuar në parimin e mbrojtjes së personalitetit, të drejtave dhe interesave të të mbrojturit.

Ligji për familje, neni 135, parasheh që personat të cilët vihen nën kujdestari, Qendra për Punë Sociale u cakton Kujdestarë.[13] Kjo nënkupton që nga momenti i vënies së personit nën kujdestari si dhe gjatë kohës së qëndrimit të tij, monitorimi ndaj të përkujdesurit duhet realizuar nga ana e kujdestarit në mënyrë precize, gjithmone duke marrur parasysh mirëqenien e tij si dhe zhvillimin më të drejtë të tij.

Sipas të drejtës sonë, kujdestar mund të përcaktohet personi i cili ka cilësi personale, aftësi për kryerjen e obligimit të kujdestarit, dhe i cili paraprakisht do të japë pëlqim që të jetë kujdestar. Bazuar nga ajo qëu theksua më sipër, kjo do të thotë që përzgjedhja bëhet gjithmonë mvarësisht vullnetit dhe dëshirës së kujdestarit që nënkupton se nuk është detyrim ligjor.

Gjatë vënies të së miturit nën kujdestari, së pari për kujdestar përcaktohen më të afërmit e tij. Përgjjatë vendosjes nën kujdestari, gjithashtu merret parasysh edhe dëshira e të miturit,

[13] (''Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë''), nr.135 nga 20.10.2014

kuptohet, nëse është në gjendje të vlerësoj dhe të shpreh dëshirat e tij.[14]Ligji për familje ka paraparë edhe disa cilësi dhe karakteristika të kujdestarit.Parimisht, atë e cilëson si person fizik me aftësi të plotë veprimi dhe cilësi personale për realizimin e funksionit të tij si kujdestar.Në radhë të dytë, funksioni kujdestar, ushtrohet në mënyrë vullnetare. Kjo nënkupton se kujdestaria është veprimtari vullnetare, e cila realizohet pa shpërblim. Ajo nuk përmban karakterin obligues dhe se a do të pajtohet personi në realizimin e këtij obligimi, varet nga vullneti i tij.

Gjithashtu ligji parasheh edhe rastet kur një person nuk mund të emërohet kujdestar si rastet më poshtë: [15]

1. Personit të cilit i është marrë e drejta prindërore;
2. Personit të cilit i është hequr apo kufizuar aftësia e veprimit;
3. Personit interesat e të cilit janë në kundërshtim me interesat e personave nën kujdestari, gjegjësisht i cili nuk jep garancion se do të përkujdeset për personin nën kujdestari;
4. Personi nga i cili, duke u bazuar nga sjellja e tij e mëparshme dhe e tanishme, cilësitë personale dhe si dhe marëdhëniet me personin nën kujdestari dhe prindërit e tij, nuk mund të pritet se do ta kryej në rregull funksionin e kujdestarit.

Mirëpo, gjatë përcaktimit të kujdestarit, alternativë më e mirë për realizimin më të sukseshëm të këtij funksioni të kujdestarit i jepet prioritet anëtarëve të familjes të të përkujdesurit, pasi që vlerësohet se ata janë të njoftuar paraprakisht me nevojat dhe sjelljet e të përkujdesurit.

Në fazën e emërimit të kujdestarit, organi i kujdestarisë gjithashtu duhet të konsiderojë edhe dëshirat e personit të përkujdesur, nëse ai është në gjendje t'i shpreh të njejtat si dhe dëshirat e më të afërmve të të përkujdesurit.

[14]Zendeli, E. , Selmani-Bakiu, A ., Mickoviq, D., Ristov, A. , (2020) ''E drejta Familjare'' Tetovë, faqe 306

[15] (''Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë''), Ligji për familje neni 139, (2015)

1.6. Pushimi i kujdestarisë

Kur jemi tek ushtrimi i kujdestarisë, ligjvënësi nuk ka paraparë ndonjë kohë të caktur ndaj personave të cilët kanë nevojë për atë mbrojtje. Kjo lë të nënkuptohet që obligimi mund të zgjasë deri sa të ekzistojnë shkaqe dhe arsye për ofrimin e asaj mbrojtje, mvarësisht nga nevoja e personit të vënë nën kujdestari.Mirëpo, të kujdesurit ndaj personit të caktuar nga ana e kujdestarit, mund të pushojë edhe para nevojës së tij për të qenë nën kujdstari.,

Gjithashtu ligji, për familje shprehimisht, e ka paraparë edhe në rast se vdes kujdestari, dhe nëse me vullnetin e tij e ndalon së ushtruari obligimin si kujdestar ose, nëse, lindin rrethana të cilat e pengojnë kujdestarin të kryej obligimin e tij, Qendra për Punë Sociale, obligohet që menjëherë të ndërrmarrë masa për mbrojtjen e interesave të personit nën kujdestari si dhe në të njejtën kohë t'i caktojë kujdestar të ri.

Sipas të drejtës sonë, kujdestaria mund të pushojë në këto raste: 1. me vdekjen e kujdestarit, 2. me pushimin e kujdstarisë, 3. me shkarkimin e kujdestarit, 4. me kërkesen e kujdestarit që të lirohet nga ushtrimi i kujdestarisë.

1. Obligimi i kujdestarisë pushon me vdekjene e kujdestarit. Kjo nënkupton se është e drejtë e pabartshme, e cila nuk mundet të transmetohet tek personat e tretë, përshak natyrës së saj personale. Kjo ndërlidhet me vetë cilësitë personale, kualitetin dhe aftësitë e kujdestarit, andaj obligimi i kujdestarit pushon me vdekjen e tij.

2. Obligmi i kujdestarisë gjithashtu mund të pushojë edhe me pushimin e nevojës për kujdestar. Kjo mundësohet pasi të jenë plotësuar të gjitha qëllimet e kujdestarisë, respektivisht pasi të mos ekzistojë më arsyeja dhe nevoja për kujdestar të vërtetuar sipas ligjit.[16]

[16] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A. , Mickoviq, D.,Ristov,A.(2020) , ''E drejta Familjare'' , Tetovë ,f. 313

Pasi të mbaroj ky obligim, Qendra për Punë Socile do të njoftojë kujdestarin që brenda një afati të caktuar të dorëzojë raport lidhur me obligimet si dhe gjendjen e pasurisë së personit nën kujdestari, si dhe t'ia dorëzojë pasurinë në administrim personit nën kujdestri, gjegjësisht prindit ose adoptuesit.

3. Kujdestaria gjithashtu mund të pushoj edhe me shkarkimi e kujdestarit. Në këtë rast Qendra për Punë Sociale do ta shkarkoj kujdestarin, nëse vëren se nuk e përmbush obligimin e tij me kujdes si dhe keqperdorë kompetencat, si dhe me punën e tij rrezikon interesat e personit të vënë nën kujdestari, ose nëse konstaton se është e arsyeshme vënia e kujdestrit të ri.

4. Para së gjithash, me kërkesën e tij po ashtu mund të pushojë ushtrimi i obligimit nga ana e kujdestarit. Mirëpo, Qendra për Punë Sociale do ta lirojë nga ky obligim kujdestarin duke u nisur nga interesi i fëmijës më së voni tre muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.[17]

---

[17] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A. , Mickoviq, D.,Ristov,A.(2020) , ''E drejta Familjare'' , Tetovë ,f. 313

KAPITULLI I DYTË: TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E KUJDESTARIT

2.1. Obligimet e kujdestarit

Ligji për familje thotë: "Kujdestari është i obliguar në bazë të kompetencave ligjore, me ndërgjegje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari dhe me ndërgjegje të udhëheq me pronën e tij''. [18]

Kjo don të thotë që obligimet e kujdestarit janë të fokusuara në kahje të ndryshme. Sidoqoftë, çështja e mbrojtjes së personalitetit dhe dinjitetit të fëmisë konsiderohet si një ndër obligimet më të rëndësishëm dhe si një ndër faktorët kyç që ndikon në zhvimillimin dhe mirëqeien e fëmijës së mitur, ndaj të cilit ofrohet ajo mbrojtje. Krahas këtyre obligimeve të lartëpermendura, përfshihen edhe kujdesi për shendetin dhe edukimin e të miturit.[19]

E drejta për tu edukuar, është një prej të drejtave themelore që njihet nga Konventa për të drejtat e fëmijeve e cila thotë: "Shtetet palë njohin të drejtën e femijës për arsimim dhe me synim për të arritur këtë të drejtë në mënyrë progresive dhe të barabartë .[20]

Në rast se i përkujdesuri është i moshës madhore, obligimi i kujdestarit kryesisht drejtohet në kujdesin për shëndetin e tij, aftësimin e tij për kryerjen e ndonjë profesioni të caktuar, si dhe për nevojat e tjera të të përkujdesurit.

Për dallim nga të drejtat dhe interesat e të përkujdesurit, kujdesi ndaj pronës së tij konsiderohet me më pak rëndësi, megjithatë, nuk duhet shmangur kujdesit ndaj pronës tij, pasi që pa të s'mund të sigurohet zhvillimi dhe mbrojtja e personit si dhe realizimi i kujdestarisë.

Andaj, obligimet e tij ndaj pronës së të përkujdesurit konsiderohen sikur të ishte prindi i tij.

---

[18] (''Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë), nr. 153, 20.10.2014
[19] Spiroviq-Trpenovka, L., Mickoviq, D., Ristov A . (2013)''*E drejta Familjare* ", f. 268
[20] Convention on the Right of the Child -Article 28

2.2. Të drejtat e kujdestarit

Përveç obligimeve që luajn rol të rëndësishëm në realizimin e kujdestarisë, po ashtu kujdestari posedon edhe disa të drejta. Ligjvënësi ka paraparë që "kujdestrari i kryen obligimet e tij, me të drejtë pa kompenzim". Por, në disa raste, ky rregull bën përjashtim nga e cila i jepet e drejta e kompenzimit në lidhje me harxhimet dhe gjithashtu posedon të drejtën në shpërblim.[21]

Gjatë mbrojtjes të së drejtave dhe interesave të fëmijëve, kujdestari për punën e tij që e kryen ka të drejtën e kompenzimit të harxhimeve të arsyeshme të cilat ai i relizon, lartësinë e të së cilës e cakton Qendra për Punë Sociale.

Po ashtu, në qoftë se kujdestari, në përjashtim të obligimeve të tij, kryen ndonjë obligim shtesë dhe atë e realizon me sukses, Qendra për Punë Sociale do ta shpërblejë. Të dyja sëbashku shpërblimin dhe kompensimin e harxhimeve e miraton Qendra për Punë Sociale nga të ardhurat e personit nën kujdestari, por nëse me këto do rrezikohej mirëmbajtja e personit nën kujdestri, atëherë harxhimet e tilla do ti realizojë shteti.[22]

[21] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A , Mickoviq, D.,Ristov,A.(2020) , ''*E drejta Familjare*'' , Tetovë , f.308
[22] Spiroviq-Trpenovka, L., Mickoviq, D., Ristov A . (2013)''*E drejta Familjare* ", f. 272

2.3. Përgjegjësia e kujdestarit

Më lart theksuam rolin dhe rëndësinë e kujdestarit në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëvë, në rastet kur ata gjenden të privuar nga moskujdesi i prindërve të tyre , ku si pasojë e këtij moskujdesi mund të shkatojë pasoja në zhvillimin e tyre psiko-fizik.Pra, ai(kujdestari), me përgjegjësi më tëlartë ligjore ligjore dhe morale duhet kryer detyrën e tij kundrejt fëmijës.

Por, jo në të gjitha rastet kujdestari me përgjegjesi dhe me ndërgjegje e kryen obligimin e tij, ku si pasojë mund të vijë deri tek neglizhenca e të kujdesurit ndaj personalitetit dhe pasurisë së të përkujdesurit, edhe pse këta obligime bien në përgjegjesinë e kujdestarit dhe Organit të kujdestarisë .[23]

Kështu që, kur vërehet neglizhenca e punës nga ana e kujdestarit si dhe Organit të kujdestrisë, nga e cila do të shkatonte pasoja në cënimin e të drejtave dhe interesave të të përkujdesurit, në raste të këtilla, ligjvënësi parasheh mundësinë e parashtrimit të ankesës. Në këto raste Ligji për familje thotë: " Personi nën kujdestari, nësë është në gjendje të bëjë një gjë të tillë, familjarët e tij si dhe ndërrmarrjet dhe institucionet të paraparë në nenin 128 nga ky ligj, si dhe çdo qytetar mund të parashtroj ankesë për punën e organit të kujdestarisë dhe kujdestarit". Ankesa ndaj kujdestarit dërgohet tek Qendra për Punë Sociale, kurse ankesa ndaj Organit të kujdestarisë dërgohet deri tek Ministria për Punë dhe Politikë Sociale.[24]

Nga ankesa e dërguar për punën e kujdestarit, nëse organi i kujdestarisë vëren parregullësi në realizimin e qëllimit të kujdestarisë, organi është i detyruar të ndërrmerrë masa të caktuara, si dhe nëse e sheh të nevojshme të caktoj kujdestar të ri. Kurse, nësë ankesa është drejtuar tek Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe nëse e njejta vlerëson se ankesa është e bazuar, do ti japë udhëzime Qendrës për Punë Socile se cilat masa duhet ti ndërrmarrë.

[23] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A , Mickoviq, D.,Ristov,A.(2020) , *''E drejta Familjare''* , Tetovë, f.312
[24] (" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë''), nr. 131 , 20.10.2014

Duke bërë vlerësimin e gjendjes së fëmijëve, të cilët ishin të vendosur në shtëpi të vogla grupore(SHGV), pikërisht aty, në vendin ku duhej tu sigurohjej mbrojtje atyre,Avokati i Popullit sipas 7 parahtresave, 5 prejt të cilave ishin të realizuara me iniciativën e tij, konstatoi se kujdesi ndaj fëmijëve nuk realizohej me përgjegjësi nga kujdestarët.Gjatë këtij procesi vërejti ikjen e fëmijlëve nga shtëpitë e vogla grupore për një kohë të gjatë.

Duke vlerësuar punën e organeve në lidhje me këtë çështje si dhe gjetjen dhe kthimin e fëmijëve në shtëpinë kujdesëse, po ashtu konstatoi lidhejt jashtë martesore të dy të miturave, gjë e cila është në kundërshtim me ligjin dhe në dëm të tyre.Si pasojë e ikjes, fëmijët e kishin të vështirë prap të risocializoheshin.[25]

Për të përmisuar gjendjen e fëmijëve dhe respektimin e drejtave të tyre, Avokati i Popullillit rekomandoi se duhet siguruar ekipe profesionale për të punuar me fëmijët me çrregullime në sjellje dhe fëmijë në rrezik të cilët janë shfrytëzues të shtëpive grupore dhe të aplikojnë forma të tjera jashtëinstitucionale të kujdesit për këta fëmijë për socializimin dhe risocialiyimin e tyre më të duhur dhe më efikas.[26]

[25] Raport vjetor Avokatit të Popullit për nivelin e sigurimit, të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, Mars (2021), Shkup, www.ombudsman.mk, f.42

[26] Raport vjetor Avokatit të Popullit për nivelin e sigurimit, të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, Mars (2021), Shkup, www.ombudsman.mk,f.50

3. KAPITULLI I TRETË: LLOJET E KUJDESTARISË

3.1. Kujdestaria ndaj personave të mitur -arsyet e vendosjes nën kujdestari

Për të definuar termin fëmijë i mitur , në sistemet juridike të shteteve të ndryshme për kritere merren: mosha, pjekuria mendore, pjekuria seksuale, pjekuria intelektuale[27]. Kur jemi tek ligji për familje, nuk mund të vërejmë ndonjë dispozitë të veçantë për fëmijën, por në nenin 10, paragrafi 2, ka një dispozitë sipas së cilës “,mosha madhore arrihet me mbushjen moshës 18 vjeçare, kur i mituri fiton zotësinë e veprimit”, kurse Konventa për të drejtat e fëmijës si instrument më domëthënës në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, femijën e konsideron si qenie njerëzore që nuk ka arritur moshën tetëmbëdhjetvjeçare, perveç rasteve, kur sipas ligjit ka të bëj me fëmijën, mosha madhore nuk arrihet më herët.[28]

Faktorët e ndryshëm social si varfëria, papunësia, jostabiliteti ekonomik në të shumtën e rasteve mund të jënë indikatorë në prishjen e stabilitetit mbrenda familjes, faktorë të cilët do t’u pamundësojë prindërve të realizojnë të drejtën prindërore në mënyrë të plotë. Si pasojë e neglizhences së prindërve kundrejt fëmijëve të tyre, këta të dytët (fëmijët) do ta pësojnë në jetën e tyre.

[27] Arifi, B., Ratkoceri, V., Selmani-Bakiu, A., Metaj-Stojanova,A., Ibish,B., (2022), “Të drejtat e fëmijeve, sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetove,f.207
[28] Ibid,f.208

Sipas statistikave të marra nga nga Qendra për Pune Sociale arsyet e vendosjes së fëmijës të mitur nën kujdestari konsiderohen të jenë:[29]

1) Vdekja e të dy prindërve
2) kushtet e papërshtatshme për jetesë në familjen biologjike
3) keqpërdorim seksual nga prindi, në drejtim tjetër të panjohur
4) heqja e së drejtës së lëndës së fëmijës nga nga tjetra QPS sipas ndërrimit të kmpetencës
5) fëmi të mitur të neglizhuar dhe të lënë anash nga prindërit, të cilët kujdesen për nevojat dhe interesat e tyre

6) Keqpërdorim seksual nga prindi

Ku Ligji për familje thotë: "Nën kujdestari do të vihet personi i mitur pa kujdes prindëror''. Gjatë vendosjes së të miturit nën kujdestari Qendra për Punë Sociale do të udhëhiqet nga mbrojtja të drejtave dhe interesave të të miturit dhe organi do ti caktoj kujdestar .[30]

Sipas të së drejtës sonë, fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet: [31]fëmija prindërit e të cilit janë të zhdukur, të panjohur ose janë me vendbanim të panjohur më shumë se një vit, prindërit e të cilit, pa marrë parasysh arsyet, nuk i kryejnë të drejtat dhe obligimet e tyre prindërore.

Për më shumë, nga ajo që u theksua më lartë, sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtje sociale si dhe formen e mbrojtjes institucionale shteti u mundëson mbrojtje fëmijëve duke i akomoduar në institucione të mbrojtjes sociale. Të drejtë në shfrytëzimin e kësaj mbrojtje kanë familjet, të cilat janë të prekuara nga vështirësitë e kushtëve të të jetuarit, gjithashtu, edhe fëmijët të privuar nga kujdesi prindëror, pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhen.

Kjo formë e kujdesit mund të ofrohet si: kujdes i përgjithshëm, i specializuar, rastësor intervenues dhe familjar. Megjithatë, vendosja e fëmijëve në një familje kujdestarie, konsiderohet të jetë si alternativë më e mirë e mbrojtjes së fëmijëve, pasi që kjo do të kontribuonte në zhvillimin e duhur psiko-social të të miturit. Sidoqoftë, duhet cekur se gjatë zgjedhjes së kësaj alternative të të kujdesurit në ambient familjar, duhet pasur parasysh edhe

[29] Statistika nga Qendra për punë Sociale, Kumanovë, 14.02.2023, nr.arhivues: 302-191/1
[30] Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf
[31] Statistika nga Institucioni Publik, Qendra Ndërkomunale Kumanovë, 14.02.2023, nr.arhivues 0302-191/1

gjendja e përgjithshme shëndetësore dhe përshtatshmëria e të përkujdesurit si dhe gjithë anëtarëve të familjes.

Bazuar nga statiskat e marrurra nga Qendra për Punë Sociale, udhëhequr nga raporti i vitit 2021:[32]

19 Fëmijë jetojnë në kujdes familjar

-2 fëmijë në OE, SOS Qendra për Fëmijë Shkup

-31 Fëmijë te kujdestari

-2 Fëmijë në Institucionin Publik Institucion Special në Demir Kapi

-3 Fëmijë në Institucioniн Publik Foshnjat dhe Fëmijë të Vegjël

-2 Fëmijë në Institucionin Publik Shtëpia e Fëmijëve 11 Tetori Shkup

-3 Fëmijë në Institucioni Publik me Probleme Sociale Edukuese.

Pyetjes së parashtruar deri tek Qendra për Punë Sociale: Sa është numri i rasteve të fëmijëve të vendosur nën kujdestari duke filluar nga viti 2015-2022? Qendra u përgjigj se IP Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale ka vendosur 82 fëmijë në kujdestari duke filluar nga viti 2015 e deri më vitin 2022.[33]

[32] Statistika nga Qendra për Punë Sociale, Kumanovë14.02.2023
nr.arhivues: nr.0302-258/1
[33] Përgjigje të marra në bazë të pyetësorit nga Qendra për Punë Sociale

3.2. Autorizimet dhe obligimet e kujdestarit

E veçanta e autorizimit dhe obligimit të kujdestarit ndaj personave të mitur qëndron në aplikimin e vënies nën kujdestari të personave të cilët kanë mbetur pa kujdes prindëror, si dhe synimi i të cilit është të realizoj me sukses këtë obligim.[34] Andaj, nga këtu obligimi i kujdestarit ndaj fëmijës duhet baraspeshur dhe vlerësuar sikur të ishte prindi i tij.

Bazuar nga e potencuara më lart sipas legjislacionit familjar, obligon kujdestarin që të kujdeset për personalitetin e të miturit si të ishte prindi i tij, e veçantërisht për shëndetin, edukimin, arsimimin, përgatitje për jetë të pamvarur dhe punë. (neni 160)

Obligimi ndaj shëndetit ka të bëjë veçanërisht me të kujdesurit ndaj personit të mitur për shëndetin fizik, mental dhe të ofruarit e të gjitha shërbimeve që ndërlidhen me shendetin si dhe mirëqënien e tij.[35] Këto janë komponente shumë të rëndësishme në ecurinë e zhvillimit të fëmijës, të cilat janë njëkohësisht obligime nga Konventa për të Drejtat e Fëmijeve dhe që obligojnë shtetin në respektimin e të drejtave të fëmijëve të vendosur nën kujdesin e organit kompetent, me qëllim të mbrojtjes, ose trajtimit të shëndetit të tij fizik ose mendor, për rishikim periodik dhe kontrollit të tij që i bëhet gjatë vendosjes së tij.

Gjithashtu, arsimimi dhe edukimi hyjnë në pjesën e obligimeve të kujdestarit, të cilat janë mjaft domethënëse gjatë procesit jetësor të zhvillimit të fëmisë, të cilat kontribuojnë në aftësimin e ti/saj profesional si dhe të mësuarit për vlerat e jetës që do ta ndjekin të përkujdesurin gjatë jetës së tij.

Duke u bazuar në raportin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2021, i cili cilësohet si ‘’vit i pandemisë’’, ai në sferën e të drejtave të fëjëve për arsim vërejti shkeljen e të drejtave të tyre për arsim cilësor.Gjatë këtij viti numri i ankësave të inicuara ishte konsiderueshëm i madh.Këto ankesa të drejtuara drejt Avokatit të Popullit, kishin të bënin me ndjekjen e mësimeve në distance nga nxënësit, sigurimin e materialeve mësimore, pamundësia e regjistrimit të tyre në

[34] Zendeli,E. , Selmani-Bakiu, A , Mickoviq, D.,Ristov,A.(2020) , ‘’E drejta Familjare’’ , Tetovë, f.315
[35] Ibid, f.315

shkolla. Si rezultat i hulumtimeve të ralizuara, u vërtetua se në 52% të shkollave,për shkaqe objective dhe subjective nxënësit nuk kanë mundur të ndjekin mësimin ashtu siç duhet, andaj edhe nxënësve u ka munguar suksesi.[36]

Aftësimi për jetë dhe punë të pavarur së bashku me gjitha obligimet e tjera siç janë kujdesi për shendetin, edukimin dhe arsimimin e te përkujdesurit, përbëjnë një ndër përpjekjet e fundit të kujdestarit ndaj fëmijës të mitur. Varësisht nga suksesi se sa do të arrijë në përmbushjen e këtyre obligimeve në relizimin me sukses të kujdestarisë, aq më shumë në të ardhmen do ta përgatiste të miturin për të qënë të pavarur si dhe do ta aftësonte ta ndërrmarrë kujdesin ndaj vetes së tij dhe për të drejtat dhe interesat e veta.

Përvec këtyre obligimeve më, kujdestari i femijës së mitur ka për detyrim edhe për përkujdesjen për pronën e fëmijës.

[36] Raport vjetor nga Avokati i Popullit, Mars ,(2021), për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, Shukup

3.3. Pushimi i kujdestarisë ndaj fëmijëve të mitur

Përpos rolit dhe qëllimit të institutcionit, si detyrime ligjore të cilat i mbart në vete si dhe duke konsideruar edhe përgjësinë e kujdestarit, supozojmë që kujdesi ndaj kësaj kategorie femijësh është i pashmangshëm. Megjithatë, në një kohë të caktuar mund të vijë deri tek pushimi i kujdestarisë, kjo nënkupton që kujdestaria vlenë gjersa ekziston nevoja dhe arsyeja për të qenë nën kujdestari. Nga momenti i mosekzistimit të këtyre shkaqeve dhe nevojave për kete mbrojtje, pushon kujdestaria ndaj personit te mitur.

Deri tek pushimi i kujdestarisë ndaj personave te mitur mund të vije në disa mënyra, edhe atë: 1. me arritjen e moshës madhore;, 2. me lidhjen e martesës para moshës madhore (me emancipim);, 3. me adoptim;, 4. me pushimin e shkaqeve ligjore për vendosjen e një personi të mitur nën kujdestari;, 5. me vdekjen e personit të mitur.[37]

[37] Zendeli, E., Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), *"E drejta Familjare"* Tetovë, f,316

3.4. Kujdestaria ndaj personave të cilëve i'u është hequr ose kufizuar aftësia e plotë për të vepruar – Arsyet e vendosjes nën kujdestari të personit madhor

Jo në te gjitha rastet aplikohet vënia nën kujdestari vetëm ndaj femijëve te mitur, po ashtu është e nevojshëm vënia nën kujdestari e një kategorie të caktuar personash të cilët për shkak të arsyeve të ndryshme si: sëmundjeve shpirtërore, pengesat të zhvillimit psiqik nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre si dhe për të drejtat dhe interesat e tyre. Në këte kategori mund të përfshihen edhe personat madhorë. Andaj personave të cilëve me aktvendim të gjykatës i'u është marrë pjesërisht ose tërësisht aftësia për të vepruar Qendra për Punë Sociale i vë nën kujdestari.[38] Parasegjithash për t'u marur aftësinë e veprimit duhet vërtetuar nëse ekzistojnë arsye për heqjen e aftësisë së tillë të veprimit.j

Siç e përshkruan edhe autori, Abdulla Aliu në librin e tij: ***"Aftësia për të vepruar e personave fizik është aftësi që t'i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në mënyrë të pamvarur".***[39]

j

Sipas legjislacionit tonë familjar neni 10 paragrafi 2 thotë: "kjo aftësi e veprimit fitohet njëkohësisht me mbushjen e moshës madhore, e cila llogaritet të arrihet në moshën 18-vjeçare".[40]

Por, siç theksuam më lart, në disa raste ekzistonin disa arsye që mund të paraqitnin pengesë në ushtrimin e kësaj të drejte, e drejtë e cila mund tu shkaktonte pengesë në të kujdesurit për vetë-veten, të drejtat dhe intersat e tyre. Aktvendimin për marrjen, përndryshe kufizimin e aftësisë së veprimit gjykata menjëherë e dorëzon tek Qendra për Punë Sociale, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, e vë nën kujdestari personin madhor.[41]

---

[38] Zendeli, E., Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), *"E drejta Familjare"* Tetovë, f.317

[39] Alia,A., (2007), ''E drejta Civile I- pjesa e përgjithshme '' Prishtinë, f.124

[40] https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_semejstvo_osnoven.pdf

[41] https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_semejstvo_osnoven.pdf

3.5. Kujdestaria ndaj personave të cilëve i'u është hequr ose kufizuar aftësia e plotë për të vepruar – Arsyet e vendosjes nën kujdestari të personit madhor

Nga të gjitha faktet e potencura më lart që kishin të bënin rreth personave madhor të cilët janë privuar nga aftësia e tyre tyre per të vepruar, mund te konkludojme që aurizimet dhe obligimet e kujdestarit kanë të bejnë me faktin nëse i'u është marrë apo kufizuar ajo aftësi për të vepruar.[42]

Nga kjo rrjedh se, kujdestari i personit të cilit i është marrë apo kufizuar aftesia për të vepruar, është i obliguar veçantërisht të kujdeset për personalitetin, të drejtat e tij, interest, akomodimin dhe shëndetin e tij , duke pasur parasysh arsyet per te cilat i është marrë, përndryshe kufizuar aftësia e veprimit, duke insistuar që ato të mënjanohen, kurse personi të aftësohet per jetë dhe punë të pavarur.(Ligji për familje, Gazata Zyrtare e RM, 2015, neni 167).[43]

Obligimi i kujdestarit ndaj personit madhor posaçërisht qëndron në ofrimin e mbrojtjes ndaj shëndetit të tij, si dhe të vë në funksion të gjitha masat të cilat arsyetojnë vendosjen e personit nën kujdestari, si dhe të realizoj gjithcka që është e nevojshme për ta pavarsuar për jetë të mëtutjeshme.

Kujdestari i personit të cilit i është marrë aftësia për të vepruar, ka të drejta dhe detyrime të kujdestarit të personit të mitur i cili ka mbushur 15 vjet jetë. (Ligji per familje neni 168, paragrafi 2).[44]

Andaj Gjykata është e detyruar menjeherë të njoftojë Qendrën për Punë Sociale kur të ngrihet procedura për marrjen e aftesisë per të vepruar personit. (Ligji për familje neni 169 paragrafi 1)

---

[42] Spiroviq-Terpenovska ,L., Mickovoq, D., Ristov,A., " *E drejta familjare* ",(2013), Shkup, f.280

[43]Ligji për familje, www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[44]Ligji për familje, www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноемв

Kuptohet, nëse e sheh të nevojshme Qendra për Punë Sociale do ti caktoj kujdestar të përkohshëm personit gjatë procedures së marrej së aftesisë për të vepruruar.[45]

Ky obligim mund të pushojë menjëher pasi Qendra per Punë Sociale do të caktoj kujdestar të përhershëm.

3.6. Pushimi i kujdestarisë ndaj personave të cilëve i'u është hequr plotësisht aftësia për të vepruar

Ligji per familje, neni 172, e ka paraparë shprehimisht pushimin e kujdestarisë ndaj personave të cilve i'u është marrë aftësia për të vepruar, i cili thotë: Kujdestria ndaj personit të cilit i është marrur aftësia për të vepruar pushon kur me aktvendim të Gjykatës do t'i kthehet aftësia për të vepruar. Kjo le të nënkuptohet që nga momenti i kthimit të aftësisë për të vepruar, pushon edhe nevoja për kujdestar ndaj personit të tillë.[46]

Prandaj, nëse kujdestari e konstaton se ndaj personit të të cilit i është marrë aftësia për të vepruar, janë krijuar rrethana të cilat dërgojnë deri tek nevoja për kthimin e aftësisë për të vepruar, pra për ndryshimin e vendimit të mëparshem, kujdestari është i obliguar ta njoftojë Qenderën për Punë Sociale.[47]

Po ashtu edhe me vdekjen e personit, të cilit i është marre plotësisht aftësia për të vepruar, pushon kujdestaria, fakt ekzistues nga e cila pushon nevoja për kujdestarë.

---

[45]Ligji për familje,www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноемв

[46]Ligji për familje https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[47] Zendeli, E..Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), " E drejta familjare ", Tetove , f.319

4. KAPITULLI I KATËRT: KUJDESTARIA PËR RASTE TË VEÇANTA

Përveç kujdetarisë ndaj fëmijëve të mitur si dhe personave të cilëve i'u është marrë aftësia për të vepruar, ligji për familje ka paparë kujdestari edhe për raste më specifike. Qëllimi i këtij lloji të kujdestarisë shërben në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike të disa personave të caktuar, pavarësisht aftësisë së tyre për të vepruar.[48]

Me këtë rast Ligji për familje neni 173 thotë: "Qendra për Punë Sociale do ti caktoj kujdestar për punë të veçanta ose për disa çështje të caktuar ndaj personit të cilit nuk i dihet vendbanimi, i cili nuk ka përfaqësues ligjor, pronarit të panjohur të pronës kur është e nevojshme të kujdeset për atë pronë, si dhe në rastet e tjera kur ajo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave te personave individual".

Qendra për Punë Sociale mund tu caktoj kujdestar të veçantë:

1. personit ndaj të cilit prindërit e ushtrojjnë të drejtën prindërore
2. për lidhjen e akteve juridike mes tyre, si dhe në rastet e tjera kur interestat e tyre janë në kundërshtim
3. personi nën kujdestari për udhëheqjen e kontestit mes tij dhe kujdestarit
4. për lidhjen e akteve juridike mes tyre
5. si dhe në raste të tjera kur iterestat e tyre janë në kundershtim[49] (Ligji për familje neni 174)

Në rastet e kontesteve që kanë të bëjnë me personat e mitur ose personat e tjerë ndaj të cilëve ushtrohet e drejta prindërore, të cilët kanë kujdestar të njejtë, duhet të drejtohet kontesti ose të lidhet akti juridik në interesin tyre, përndryshe kur personat nën kujdestari janë në

[48] Zendeli, E..Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), " E drejta familjare ", Tetove , f.320
[49]Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

kundërshtim, Qendra për Punë Sociale do t'u caktoj kujdestar të veçantë për drejtimin e kontestit, përndryshe në lidhjen e aktit juridik.[50]

Kur prindërit, kujdestarët ose organet shtetërore në kryerjen e obligimit, do të njoftohen për rastet nga paragrafi 2 i këtij neni, janë të obliguar të e njoftojnë Qendrën për Punë Sociale.[51]

[50]Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[51]Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

4.1. Kujdestaria ndaj personave me vendbanim të panjohur

Në rastet e tilla kujdestar u caktohet personave kur nuk u dihet vendbanimi ose personave të cilët janë në munges, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.[52]

Në kategorinë e këtyre personave përfshihen:[53]

1. personat me vendbanim të panjohur
2. personat që nuk kanë përfaqësues

Këtyre personave u caktohet kujdestar i veçantë për punë të veçanta, ose për lloj të caktuar të punëve, për të cilët vendos Qendra për Punë Sociale.

[52] Zendeli, E..Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), " E drejta familjare ", Tetove , f.320
[53] ibid

4.2. Kujdestari i pasurisë të cilit nuk i dihet pronari

Specifika e këtij lloji të kujdestarisë qëndron nga mosnjohja e pronarit, andaj në raste të tilla caktohet kujdestar ndaj asaj pasurie, sepse ekziston rreziku i dëmtimit të asaj prone si dhe nga vet fakti që nuk ka kush të kujdeset për atë pasuri.[54]

Në këtë kategori pasurish përfshihen si [55]: pasuritë e braktisura, pasuri pa trashëgimtar si dhe në rastet e tjera kur pronari i pasurisë nuk njihet.

Kujdestari është i obliguar të kujdeset për atë pasuri si dhe mund të disponoj me të vetem nëse e autorizon Qendra për Punë Sociale.

Megjithatë, kjo kujdestari mund edhe të pushoj nga momenti i gjetjes së pronarit të pasurisë.

[54] Zendeli, E..Selmai-Bakiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A., (2020), " E drejta familjare ", Tetove, f.321
[55] ibid

4.3. Kujdestari për shtetas të huaj

Ligji për familje neni 175, parasheh: Qendra për Punë Sociale në rastet e parapara me këtë ligj, do të marrë masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të shtetasve të huaj, gjersa organi shtetëror, shtetas i të cilit është ai, nuk sjell vendim e duhur dhe ndërrmerr masa të caktuara.[56]

Po ashtu edhe Konventa e të Drejtave obligon të gjitha shtetet nënshkruese të Konventes që të kujdesen në mënyrë të veçant ndaj fëmijëve pa prindër.Në të njetën mënyrë ky obligim referohet edhe ndaj fëmijëve të cilët në cfarë do rrethane mund të ndodhen në territorin e ndonjë shteti tjetër.

Ky lloj kujdestaie ka të bëjë kysesisht me fëmijët e mitur të huaj, të cilët kalojnë në shtet tjetër të pa shoqëruar nga prindërit e tyre.Në raste të tilla caktimi i kujdestarit është mjaftë e rendësishme dhe e cila duhet bëhet me urgjence, pasi që kjo kontribuon në mbrojtjen e mirëqenies së fëmijës. [57]

Kujdestarët në mënyrë specifike caktohent për fëmijët e pashoqëruar, të cilët aplikojnë për azil ose ata të cilët indentifikohen si viktima të trafikimit me njerëz. Mëgjithatë, jo të gjitha shtetet antare lejojnë që kujdestarit që të ushtrojë rolin e tij kur ka të bëjë me mbrojtjen e interesit të tij më të mire.Në disa raste kjo mbrojtje vonohet duke marur vendimin se fëmija a duhet të qëndrojë në shtet apo të kërkohet leje për qëndrim, ose alternativa tjetër të kthehet në tjetrin shtet jo nëtare ose të kthehet në shtetin e orijginës.[58]

---

[56] Ligji për familje, Gazeta zyrtare e RM, 2015

[57] Report ''Guardianship systems for unaccompanied children in the Europena Union'' ,Developments since 2014,(2022) , https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2022-guardianship-systems-developments_en.pdf , Page 8

[58] Report ''Guardianship systems for unaccompanied children in the Europena Union'' ,Developments since 2014,(2022) , https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2022-guardianship-systems-developments_en.pdf , Page 11

Duke marë parasyshë shtetet tjera anëtare, gjithashtu Maqedonia dhe Sërbia kanë krijuar mekanizma mbrojtës duke caktuar persona në mbështës e fëmijëve, që në momntin e kontaktit të tyre me ata, të cilët janë gjetur nga policia ose në kalimin kufitar.[59]

4.4. Kujdestari ndaj personave të mitur viktima të trafikimit me njerëz

Trafikimi me fëmijë është një prej fenomeneve nga e cila përballet e gjithë bota si dhe Maqedonia si shoqëri, e cila ballafaqohet me eksploatimin seksual të fëmijeve e cila paraqet rrezik social për shoqërinë, ku si rezultat shteti duhet të jetë në gadishmëri në ofrimin e mbrojtjes, në gjetjen e mekanizmave si dhe masave mbrojtëse ndaj kësaj kategorie personash, me qëllim të shmangies dhe zhdukjes së këtij fenomeni kërcënues.[60]

Sipas legjislacionit familjar, neni 177: "Fëmi - viktimë e trafikimit konsiderohet personi deri në moshën 18- vjeçare, i cili me ose pa pëlqimin e tij, në çfarë do mënyre, është bërë viktimë e trafikimit me njerëz për shkak të eksploatimit".[61]

Sipas Avokatit të Popullit shfrytëzimi i fëmijeve të mitur në çfarë do forme të eksploatimit, abuzimit seksual konsiderohet si një ndër format më të renda të trafikimit, e cila llogatitet si indikator në lënien e pasojave të rënda në zhvillimin e tyre psikologjik.[62]

Neni 177, përcakton se Qendra për Punë Sociale, në kryerjen e obligimit të saj , është e detyruar të bashkpunojë: -Me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë, kujdestarinë,

---

[59] Report ''Guardianship systems for unaccompanied children in the Europena Union'' ,Developments since 2014,(2022) , https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2022-guardianship-systems-developments_en.pdf , Page 8

[60] https://ombudsman.mk , (2012) "Извештај од спроведеното истржување за појавите на сексуална злоупотреба и сексуална експлоатација на деца " , Скопје

[61] Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[62] https://www.ombudsman.mk

familjen, prindërit dhe organet e tjera, shtëpitë, institucionet dhe personat të cilët mund t'u ndihmojnë në realizimin e interesit më të mirë të fëmijës, të bëj vlerësimin e përshtshmerinë e familjes, të ndjek sjelljen e fëmijës, të jep ndihmë profesionale familjes dhe fëmijës dhe ndërrmerr të gjitha masat për të cilat vlereson se janë në interesin më të mirë të fëmijës.[63]

Në momentin kur Qendra për Punë Sociale kur merr informacione nga Ministria e Punëve të Brendshme, se është identifikuar fëmi i mitur -viktimë e trafikut me njerëz, menjëherë duhet ndërmerrë masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtat dhe interesat e fëmijës dhe të vë nën kujdestari.

Sipas kornizave ndërkombëtare ligjore fëmijët duhet mbrojtur nga çfarë do lloj eksploatimi e posaçërisht të ndalohet çdo lloj shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, sjellje e dhunshme si trafikimi i femijëve.

Kështu që me qëllim të mbrojtjes dhe sigurisë ndaj këtyre personave duhet aplikuar mekanizma mbrojtës si dhe të ndërrmerren masa në vijim:

a.) ndihmë dhe mbrojtje të fëmijeve të cilët janë bëre viktima të trafikimit
b.) rehabilitim dhe risocializim i fëmijëve viktima,
c.) masa ndëshkuese dhe sanksionuese për kryerësit e këtyre veprave
d.) masa dhe sanksione kundër personave të cilët e kanë pasur në detyrë të kujdesen për fëmijët, por nuk e kanë kryer atë.

Një ndër aspektet më të rëndesishme dhe më adekuat në mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi me njerëz është edhe përgatitja dhe aftësimi i ekipeve profesionale, të cilët trajnohen në mënyrë të posaçme, trajnim i cili u ndihmon në çfarë do lloj sfide në tejkalimin dhe parandalimin gjatë procesit të mbrojtjes së fëmijëve nga trafikimi me njerëz.[64]

Bazuar sipas protokollit fakultativ, shtetet kanë për obligim të aplikojnë masat mbrojtëse për trajnim special, e posaçërisht trajnim juridik dhe psikologjik të personave të cilët punojnë me fëmijë viktima të trafikimit me njerëz.

---

[63]Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[64] www.ombudsman.mk , " Informate për dukurinë e trafikimit me femijë në Republiken e Maqedonisë " Shkup, 26.10.2010, f.5

Duke marrur për bazë atë që kemi theksuar më lartë, mund të themi se personat e trajnuar të cilët veç më janë pajisur me aftësi dhe shkathtësi profesionale, këto janë elemente me rëndësi, pasi që atyre u ndihmon në identifikimin më të lehtë të problemit, përkatësisht në identifikimin e fëmijëve për të cilët ekziston mundësia dhe rreziku për tu bërë viktima potencial të trafikimit si dhe fëmijët të cilët më vetëm janë berë viktima.

I një rëndësie të veçantë është edhe bashkëpunimi i institucioneve kompetente në gjetjen dhe indentifikimin e fëmijëve viktima të trafikimit siç është Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Qendrat për Punë Sociale, të cilat në mënyrë sa më shpejtë dhe në kohë duhet ofruar ndihmë dhe mbrojtje të nevojshme, në mënyrë që të pengohet cënimi i mëtutjeshëm i të drejtave të fëmijëve. Që t'i jepet mbrojtje e veçantë fëmijës viktimë e trafikut me njerëz, i caktohet kujdestar i posaçëm i trajnuar. Nevoja për mbrojtje të posaçme e këtyre fëmijëve viktima të trafikimit është e pashmangshme, nevojë e cila përmes kujdestarit të posaçëm dhe ekipeve profesionale si pedagogëve, psikologëve u ndihmon atyre në procesin e tejkalimit të traumave dhe përvojave negative të cilat i kanë përjetuar.

Bazuar në Ligjin për familje neni 177-s, Qendra për Punë Sociale gjithmonë kur është i njoftuar se eksziston rreziku i përfshirjes së fëmijës në trafikimin me njerëz, ose në mënyre tjetër të dhunshme, gjersa gjendet në familje, sipas detyrës zyrtare do të sjell vendim për mbikqyrjen e të drejtës prindërore për të gjithë fëmijët ose vetëm ndonjërit prej tyre.[65]

Kjo dukuri e keqtrajtimit të fëmijëve e posaçërisht eksploatimi i tyre si problem nuk është vetëm një problem nacional, por i tejkalon kufijtë e saj, dukuri e cila nuk mund të rregullohet nën kornizat e saj nacional për arsye të shtrirjes së gjërë të saj si fenomen i rrezikshëm shoqëror si dhe spekrit të gjerë të saj edhe në vende më të zhvillura, andaj ky problem perveç kornizave të shteteve nacionale duhet trajtuar edhe në aspektin ndërkombetar.[66]

---

[65]Ligji për familje, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

[66] www.ombudsman.mk , Raport nga " Kerkimet e kryera për dukurinë e keqpërdorimit seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve " ,(2012) Shkup, Shtator

Në rrafshin ndërkombëtar në luftimin e këtij fenomeni Konventa për të Drejtat e Femijevë trajton në mënyrë të veçantë mbrojtjen e fëmijëve dhe i siguron me nenin e saj 34, e cila obligon shtetet anëtare të mbrojnë fëmijën nga gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe keqperdorimit seksual, për atë qellim, shtetet anëtare veçantërisht i ndërrmarrin të gjitha format e duhura për parandalim:

1. nxitja ose shtrëngimimi i fëmijëve në perfshirjen e paligjshme të aktiviteteve seksuale
2. eksploatimi i fëmijëve në shfrytëzim prostitucion ose në vepra tjera të paligjshme

3.eksploatimi të fëmijëve në shfaqje dhe materiale pornografike

Protokolli fakultativ i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve viktima të trafikimit, prostitucion dhe pornografi të fëmijëve, gjenezën e kishte nga New Yorku, e cila u soll më 25 maj të vitit 2000, kurse e njejta u ratifikua nga Republika e Maqedonisë së Veriut me 12 janar të vitit 2004, në përputhshmëri me Kushtetutën e RMV-së.[67]

[67]" Të drejtat e fëmijeve ddhe mbrojta e tyre", Akademia e Shkencës dhe Artit, Harmonizimi i sistemit juridik të Maqedonisë me të Drejtën e Unionit e Evropian,(2020) libri i 9-të, Shkup

KAPITULL I PESTË: RASTE TJERA TË KUJDESTARISË

5.1. Kujdestaria sipas këndvështrimit të praktikës Gjyqësore Evropiane për të drejtat e fëmijëve

Sipas praktikës Evropiane Kujdestaria konceptohet si përgjegjësi prindërore, e cila ka të bëjë me përgjëgjësin, obligimin për zhvillimin dhe të kujdesurin rreth fëmijës së tyre. "Këshilli i Evropës mbron dhe promovon të drejtat e të gjithë njerzëve, përfshirë edhe fëmijët. Bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa e të Drejtave të Njeriut dhe standardet e tjera ligjore, Konventa promovon dhe mbron të dejtat e fëmijëve në Evropë".[68]

Megjithatë, koncepti i prindërimit (përgjegjësisë prindërore) dallon nga shteti në shtet tjetër, por pavarësisht saj secili shtet me legjislacionin e tij nacional, e mbulon të drejten e kujdestarisë dhe të qasurit në të drejta.

Në vazhdim do të analizojmë konceptin e të drejtës prindërore e sidomos të drejtën e kujdestarisë ndaj fëmijëve duke bërë krahasimin sipas disa shteteve europiane siç janë: Franca, Gjermania dhe Spanja.

Sipas së drejtës franceze, përgjegjësia prindërore thirret, konceptohet si "autoritet prindëror" në të cilën përgjegjësitë dhe obligimet e prindërve bien mbi të dy prindërit dhe e drejtë e cila obligon bashkarisht prindërit në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve të tyre. Përgjegjësia morale e prindërve qëndron në asistimin e tyre ndaj fëmijëve të tyre në edukimin, ofrimin e sigurisë si dhe ata t'i përgatisin për domethënien e vlerave jetësore, vlera të cilat kontribuojnë në zhvillimin më të mirë të tyre.[69]

---

[68] Children's rights , https://www.coe.int/en/web/children

[69] Parental responsibility-child custody and contact rights, https://ejustice.europa.eu/302/EN/parental_responsibility__child_custody_and_contact_rights?FRANCE&member=1

Duhet cekur se edhe në kontestet martesore që kanë të bëjnë me divorcin, ky element nuk paraqet ndonjë pengese në ushtrimin e të drejtës prindërore apo kujdestarinë nga të dy prindërit. Kjo nënkupton që përgjegjësia dhe obligimi ndaj fëmjës të tyre vazhdon në mënyrë të njejtë për të dy prindërit, për dallim nga e drejta prindërore në Maqedoninë e Veriut, ku në rastet e kontesteve të prindërve në rast divorci, e drejta prindërore i takon vetëm njërit prind.[70]

Gjermania sipas sistemit të saj të drejtësisë, përgjegjësinë prindërore e koncepton si përmbledhje të drejtash dhe detyrash që do të kenë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Një ndër përgjegjësitë e tyre primare që kanë të bëjnë me kujdesin është edhe kujdestaria ndaj fëmijëve të tyre.

Si përmbledhje e përgjegjësive gjithashtu bien edhe të kujdesurit ndaj pronës se tyre, e drejta e tyre për të marrur vendime për fëmijët lidhur me principin e të kujdesurit prindëror. Gjithashtu është e rëndësishme për të potencuar se një ndër përgjegjësitë kryesore është edhe të mbajturit kontakt me fëmijen dhe detyrimin për të mirëmbajtur fëmijën. Për dallim nga Franca, ku kujdestaria mbi fëmijët e tyre automatikisht u takon prindërve, sipas të së drejtës gjermane kujdestaria e përbashkët prindërore apo *Joint Custody* u takon në këto raste prindërve :

1. nëse fëmija lind nga martesa e prinderve
2. prindërit martohen pas lindjes së fëmijës
3. nëse prindërit deklarohen se dëshirojnë të kujdesen bashkarisht për fëmijën (deklaratë të kujdestarisë)
4. nëse Gjykata e familjes i jep kujdestrinë e përbashkët të fëmijës.

Megjithatë, në raste kur prindërit nuk lëshojnë deklaratë të kujdestarisë si dhe janë të pamartuar, në atë rast Gjykata e familjes mund t'i japë kujdestarinë nënës së vetme, por nëse e kërkon njëri prej prindërve, kujdestarinë e përbashkët mund t'ua japë të dy prindërve për derisa kjo shërben në interesin më të mirë të fëmijës. Gjithashtu, në rast se ushtrojnë kujdestarinë e përbashket prindërit dhe ndahen më pas, prap se prap vazhdojnë të kenë *Joint Custody* qofshin të martuar

[70] Children's Rights, https://www.coe.int/en/web/children

apo jo. Sidoqoftë, Gjykata e Familjes kujdestarinë mund t'ia japë vetëm njërit prind me kërkesën e tij, por kjo mund të kundërshtohet nga ana e fëmijës nëse i ka mbushur 14- vjet moshë.[71]

Sipas të së drejtës spanjolle, përgjegjësia prindërore njihet si : "patria potestad" apo autoriteti prindëror. Përgjegjësia prindërore kryesisht konsiderohet si përgjegjësi individuale, e posaçërisht e të dy prindërve, përgjegjësi dhe detyrim e cila orientohet në mbrojtjen e fëmijëve të mitur dhe pasurisë së personit të mitur sipas Ligjit dhe me vendim të gjykatës. Autoriteti prindëror gjithmonë ushtrohet në më të mirën e fëmijëve, ofruar në përputhshmëri me personalitetin e tyre si dhe duke konsideruar integritetin fizik dhe psiqik të tyre.

Në rast divorci përgjegjësia prindërore bie mbi të dy prindërit bashkërisht përveç se në rrethana të caktuara. Megjithatë, nëse prindërit dështojnë në kryerjen e të drejtave dhe detyrave prindërore ndaj fëmiut të mitur, atëherë sipas të së drejtës spanjolle, për ushtrimin e së drejtës prindërore mund të përcaktohen të afërmit, persona të tjerë si dhe institucione ligjore.[72]

[71]Parental responsibility-child custody and contact right, https://e-justice.europa.eu/302/EN/parental_responsibility__child_custody_and_contact_rights?BELGIUM&member=1
[72]Parental responsability-child custody and contact right, https://ejustice.europa.eu/302/EN/parental_responsibility__child_custody_and_contact_rights?SPAIN&member=1

5.2. Vështrim historik mbi të Drejtat e fëmijëve

Kohë më parë ideja mbi diskutimin, trajtimin e të drejtave të fëmijëve dhe çështja e mbrojtjes të tyre ishte absurde.[73] Gjatë periudhës së antikitetit nuk llogaritej fare si problem dhe as që mendohej t'u sigurohej trajtim special në drejtim të mbrojtjes së tyre, por në të kundërtën ata llogariteshin si "small adults'' - "të vegjël të rritur".[74] Evulimi i të drejtave të fëmijëve si dhe të njohurit e konceptit të të drejtave të fëmijëve kaloi në disa periudha: si periudha preindustriale, periudha industriale, dhe periudha mes shekullit 20 e deri më sot. Gjatë këtyre fazave, fëmijët si qenie njerëzore trajtoheshin në mënyrë më mizore si dhe nuk njihej fare koncepti i fëmijërisë.[75]

Periudha pre-industriale, cilësohej si periudhë në të cilën ideja mbi konceptin e fëmijërisë, nuk njihej aspak si periudhë e rëndësishme e jetësës së tyre. Kjo periudhë karakterizohej për mos njohjen e fëmijëve si të vegjël dhe me nevoja të veçanta, por përkundrazi ata klasifikoheshin si fëmijë të mëdhenjë ku nuk bëhej dallim kundrejt të rriturëve si pjesë e shoqërirë. Poashtu, gjatë kësaj periudhe fëmijët nuk trajtoheshin aspak si qenie njerëzore, por trajtoheshin si pronë e prindërve të tyre pa asnjë të drejtë elementare të tyre. Prindërit posedonin kontrollin e plotë (pushtetin e plotë) mbi fëmijet e tyre, madje kontrollin që kishin ndaj tyre, tejkalonte kufijtë, si rezultat i pushtetit të plotë mbi ta, mund ti trajtonin ata si të dëshironin, ku nuk shmangej ndëshkimi i tyre i cili ishte pothuajse gjithë përfshirës, njëkohësisht pranohej si shumë i natyrshëm. Fakt tjetër jo njerëzor ishte dhe vdekshmëria e foshnjave dhe fëmijëve në moshë të hershme, ku një nga katër fëmijët mund të vdiste që pranohej si shkaktar shumë i thjeshtë i vdekjes.[76]

[73]Chihdren's Rights ans Social Work, Kosher, H., Ben-Arieh, A., Hendelsman, A., (2016), New York, NY USA
[74]Right's of the child-the meaning of the child and and the rights of the children, https://www.humanium.org/en/child-rights/
[75] Chihdren's Rights ans Social Work , Kosher, H., Ben-Arieh, A., Hendelsman, A., (2016), New York, NY USA
[76] Chihdren's Rights ans Social Work ,Kosher, H., Ben-Arieh, A., Hendelsman, A., (2016), New York, NY USA

Periudha industriale - kjo periudhë përshkruhet si ndër periudhat dhe ngjarjet më me ndikim në historinë e njerëzimit, e cila pati impaktin e saj të pafund në shoqëri dhe gjithë botën. Posaçerisht, ndikimi gjatë kësaj periudhe u verejt tek kalsat punëtore të njerëzve si dhe fëmijët e shoqërive industriale.

Këtë periudhë e karakterizonte punësimi i fëmijeve nëpër fabrika dhe miniera, i cili ishte fenomen shumë i pranueshëm, fenomen që gjenezën e kishte në Britani ku dhe fillimisht u shfaq në vitet 1700, më konkretisht në shekullin e 18-të të Revulucionit.[77]

Siç potencuam edhe më lartë gjatë këtyre periudhave që përfshinin edhe fillimet e shekullit njëzet, në këto shtete të industrializuara nuk ekzistonin kapacitet dhe standarde të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si rezultat i së cilës fëmijët detyroheshin të punonin në kushte të pa përshtatshme, të cilat ishin të rrezikshme për jetën e tyre.

Pavarësisht sfidave dhe padrejtësive që i përjetuan fëmijët, kjo cështje filloi të ngrit vetëdijësimin mbi padrejtësitë që po u bëheshin, duke u përkthyer këto të padrejta në zhvillimin e të drejtave të tyre si nevojë, e cila u shndërrua në ngjarje për të mbrojtur ata në mënyrën sa më edinjitoze.[78] Hapi i parë në progresin e të drejtave të fëmijëve ishte hartimi i Deklaratës së Gjenevës për të drejtat e fëmijëve në vitin 1924 nga Eglantine Gebb, themeluese e fondit "Save the children". Gjithashtu, ndikim në avancimin e të drejtave të fëmijëve pati edhe Fondi Ndërkombëtar të Emergjencave UNICEF (1948), e cila u themelua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me theks të veçantë në mbrojtjen e të gjithë fëmijëve të botës. Më pastaj më radhë vie Deklarta Univerzale për të Drejtat e Njeriut e cila nga momenti i miratimit të saj me nenin 25-të i sigurohet mbrojtje e veçantë e cila u garanton nënës dhe fëmijes kujdes, asistencë speciale dhe mbrojtje sociale (1959). Mbi të gjitha, themelet mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve u vunë që nga momenti historik i miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve e cila kishte rol të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e po këtyre të drejtave, konventë e cila u konsiderua si arritje e madhe në spektrin e të drejtave të fëmijëve dhe i cili ishte një ndër

[77] Elias Beck, "Child labour in the Industrial Revulution" December 30, 2016
[78]History of childrens rights, https://www.unicef.org/child-rights-convention/history-child-rights

dokumentat më të ratifikuara nga ana shteteve palë dhe e cila njëkohesisht obligonte çdo shtet në mbrojtjen e fëmijëve konform me kornizat ligjore nacionale të tyre dhe sipas direktivave të tyre .[79]

[79]History of childrens rights, https://www.unicef.org/child-rights-convention/history-child-rights

5.3. Trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme. Nga kjo konstatojmë se ata i përkasin të gjithëve pa dallim dhe pa diskriminim ndaj të gjithve e posaçërisht kur flasim për kategorinë e fëmijëve të mitur me aftësi të kufizuara. Për më tepër, si të gjithë fëmijët e tjerë të mitur të cilët kanë të drejta, gjithashtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara gëzojnë po të njejtat të drejta. Megjithatë, nuk është i mjaftuëshëm vetëm gëzimi i këtyre të drejtave si dhe mbrojtja e tyre e asistimi, por është e nevojshme edhe përfshirja e tyre në shoqëri.[80] Kategoria e personave të tillë përfaqësojnë gati 15 % të popullsisë, ku duke u bazuar sipas vlerësimit të Raportit Botëror në paaftësi supozohet që 93 milion e fëmijëve nën moshën 14 vjeçare jetojnë me paaftësi të moderuar ose serve disability.[81] Ky është vetem nje supozim, numri mund te jet konsiderueshem me i madh.

Varfëria, injoranca, mungesa e shërbimeve, refuzimi i tyre përshkak të diferencimit, si rrjedhojë izolimi social i tyre, dhe mosnjohja në përgjithësi e kategorisë së këtillë të personave bëjnë që këta persona të përballen me diskriminimin në çdo sferë të jetës, gjë që gjithashtu kontribon në përjashtimin e tyre nga shoqëria.

Në pozitë më të vështirë zakonisht në baza të diskriminimit gjenden vajzat dhe gratë. Shoqëria me mentalitet patriarkati vetëm se ka theksuar edhe me thellë mos respektimin e të drejtave të gruas dhe vajzës. Ku si grupë më i pambrojtur janë ato që përballen vetëm për nga spektri i paaftësisë, por për nga statusi i tyre konsiderueshëm shkelen të drejtat e tyre, duke perfshirë edhe të ushtruarit e dhunës ndaj tyre dhe abuzimi dhe mundësitë e pakta të tyre për përfshirje në edukim, loje ose shendëtësi.[82]

---

[80] Rights of persons with disabilities, https://www.coe.int/en/web/children/children-with-disabilities

[81] Using the human rights framework to promote the rights of children with disabilities:Discussion Paper, An analysis of synergies between CRC,CRPD AND CEDAW, https://www.unicef.org/media/126396/file/Synergies-paper-Web.pdf, page 6

[82] Ibid,page 6

Historia ka dëshmuar prezencën e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar, dukuri që është ekzistente ende edhe në ditet e sotme, dhe e cila është e paevitueshme. Për këtë arsye organizata e personave me aftësi të kufizuar (DPO-s) me avokimin e fuqishëm kontriboj në njohjen emergjente të nevojës për të lëvizur gjërat në lidhje me këtë kategori.

Progres në trajtimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe personave të tillë janë tre dokumente ndërkombëtare: 1. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1989); 2. Konventa për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara (2006); dhe 3. Konventa për Eleminimin të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (1979). Në bashkëpunim secila prej konventave kontribon drejt barazisë dhe zhvillimit.[83]

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve me dy artikujt e saj 2 dhe 23 vë në dukshmëri fëmijët me aftësi të kufizuara, ku bënë të qartë obligimin që duhet ta kenë shtetet për të promovuar masa për përfshirjen dhe lirinë nga diskriminimi. Neni 2 i Konventës potencon: shtetet palë obligohen t'u garantojnë çdo fëmije të drejtat nga kjo konventë pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik dhe çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike, shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo lloj gjendje tjetër e femijës ose prindërve të tyre ose përfaqësuesve të tij ligjorë.[84] Gjithashtu, neni 23 u dedikohet këtij grupi fëmijësh ku shtetet palë pranojn se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.[85]

[83] Using the human rights framework to promote the rights of children with disabilities:Discussion Paper, An analysis of synergies between CRC,CRPD AND CEDAW, https://www.unicef.org/media/126396/file/Synergies-paper-Web.pdf ,page.7

[84] Convention on the right of the Child,https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child

[85]Using the human rights framework to promote the rights of children with disabilities:Discussion Paper, An analysis of synergies between CRC,CRPD AND CEDAW, https://www.unicef.org/media/126396/file/Synergies-paper-Web.pdf

Konventa për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar- *(CRPD)* është Konventa e Parë Internacionale e cila u kushton trajtim të veçantë kategorisë së personave të tillë, e cila siguron dhe promovon të drejtat e këtyre fëmijëve. Qëllimi parësor i kësaj konvente është fokusimi i saj në promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e gëzimit të plotë e të të gjitha këtyre të drejtave njerëzore dhe liritë fundamentale nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar, dhe gjithashtu për të kultivuar respekt për dinjitetin e tyre. Kjo konventë po ashtu u jep rëndësi pozitës dhe gjendjes së grave dhe vajzave, duke adresuar nevojën për barazi dhe drejtës, me implementimin e shumë legjislacioneve të tij.[86]

Konventa në eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas - Qëllimi kryesor i kësaj konvente është të siguroj barazi mes grave dhe burrave, në të gjitha sferat e jetës përfshi atë private dhe publike.

Pjesë e konventës CRPD-së, Maqedonia Veriore u bë në vitin 2011, nga momenti i ratifikimit të po së njejtës, në vazhdimësi tregoi rezultat në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar përshkak të reformave të realizuara në mbrojtjen sociale, edukimin, dhe zhvillimin në zonat e mosdiskriminimit, shërbimet e punës, deinstitucionalizimin, promovimin e barazisë gjinore.[87] Megjithatë, edhe përkundër harmonizimit të legjislacionit me të Drejtën Evropiane, prap se prap vërehet mos përputhje e plotë e ligjeve të cilat u referohen personave me aftësi të kufizuara me CRPD, e cila vazhdimisht theksohet në rekomandimet e komitetit për të drejtat e këtyre personave, si dhe implementimi[88] i dobët i dispozitave ligjore.

Masa e gjërë e popullsisë nga moskuptimi i qartë i paaftësisë së këtyre personave bënë që të kenë qendrim negativ ndaj tyre në përgjithësi. Kjo është si rrjedhojë e mos unifikimit të termit paaftësi të personave me aftësi të kufizuara në dokumente zyrtare.

---

[86] Using the human rights framework to promote the rights of children with disabilities:Discussion Paper, An analysis of synergies between CRC,CRPD AND CEDAW ,https://www.unicef.org/media/126396/file/Synergies-paper-Web.pdf

[87] Situational analysis of the rights of persons with disabilities in theRepublic of North Macedonia-2021, https://www.unicef.org/northmacedonia/media/11706/file/mkd-unprpd-sitan-2022.pdf , page 6

[88] Situational analysys of the rights of persons with disabilities in theRepublic of North Macedonia-2021, https://www.unicef.org/northmacedonia/media/11706/file/mkd-unprpd-sitan-2022.pdf ,page13

Nga e gjitha që potencuam vimë në perfundim se personat me aftësi të kufizuar si dhe fëmijët, tradicionalisht kanë qenë pjesë e diskriminimit, si dhe të margjinalizuar si rezultat i së cilës i'u kanë mohuar të drejtat e tyre elementare në çdo aspekt të jetës.

5.4. Studim rastesh

Në vazhdim do të sjellim disa tregime të fëmijëve të vendosur në qendra perkujdesëse duke u bazuar në pervojat e tyre gjatë qendrimit.

I. Rasti i parë ka të bejë me tregimin e një vajze 18 vjeçare, si dhe përvojën e saj e të qëndruarit në institucione.

Fati i kësaj vajze nuk ishte si i çdo fëmije që mund të përjetonte fëmijëri në ambient të ngrohtë familjar, por përkundrazi rrethanat e diktonin që të gjindej në situata të keqtrajtimit të saj nga prindi. Keqtrajtim, ku ishte e pashmangshme dhuna, ku rrihej nga prindi i saj, kjo bënte që shpesh herë s'bashku me vëllaun të iknin nga shtëpia. Për shkak të këtij trajtimi jo të drejtë ajo detyrohej të qëndroj tek shoku i vallaut s'bashku me të vëllaun. Babai, rastin e paraqiste në polici si të zhdukur për ti kthyer ata në shtëpi.

Më pastaj ata të gjithë ishin të ftuar nga shërbimet sociale, ku shërbyesja sociale e kishte pyetur nëse dëshironte të rrijë nën strehëzën për fëmijë, por vajza ishte e frikësur nga një zgjedhje e tillë. Ajo refuzoi qëndrimin në qendër. Punonjësja sociale i pohoi se po të ikte prapë nga shtëpia, më nuk do ta pyeste fare. Pas disa javësh qëndrimi me prindin e saj, ajo përsëri filloi të keqtrajtohej nga prindi, si rezultat i së cilës u morr vendim që ajo të dërgohej në qendër. Përkundër dëshirës qëndrimi në strehëz ishte më mirë se me prindin, megjithatë, jo gjithmonë, e

ka pasur mbështetjen nga punonjëset sociale kur më së shumti ia ka pasur nevojën. Pavarësisht sukseseve të saja, kjo ka ndikuar që të ketë pasiguri në jetë dhe mosbesim tek njerëzit.[89]

Rasti i radhës ka të bëjë me tregimin e përjetimit të një djali 17- vjeçar në konflikt me ligjin.

Tregimi i tij ka të bëjë me vdekjen e prindërve të tij, si pasojë e së cilës përgjegjesinë mbi kujdesin e tij e ka marrur xhaxhi i tij ku dhe ka kaluar një kohë të caktuar. Deri sa është rritur ka qëndruar me xhaxhin dhe familjen e tij, e cila është kujdesur për të. Mirëpo, qëndrimi i tij ka zgjatur vetëm deri në fillimin e shkollimit përshkak të pamundësive nga varfëria për të vazhduar kujdesi ndaj tij. Në shkollë dërgohej nga gjyshërit.Mungesa e shtëpisë së tij ka bërë që të qëndroj më shumë kohë në rrugë. Në moshën 10 vjeçare u dërgua në një strehëz për fëmijë dhe pastaj në një tjetër. Si pasojë e kësaj përvoje shpesh herë është gjendur në situatë krizash.[90]

[89] https://www.unicef.org/northmacedonia/sq/ndjehem-sikur-nuk-kam-pasur-fëmijëri, Tregimi është pjesë e fushatës, "Unë jam më shumë se ajo që ka ndodhur''e cila zbatohet në kuadër të programit ''Drejtësi për fëmijët'', Be-për drejtësi për të miturit dhe fëmijët'', të financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga UNICEF për mbeshtetjen e përpjekjeve reformuese të qeverisë për të siguruar që sistemi i drejtësisë t'i mbrojë të drejtat e të gjithë fëmijëve që bien në kontakt me ligjin.

[90] https://www.unicef.org/northmacedonia/sq/ndjehem-sikur-nuk-kam-pasur-fëmijëri, Tregimi është pjesë e fushatës, '' Unë jam më shumë se ajo që ka ndodhur''e cila zbatohet në kuadër të programit ''Drejtësi për fëmijët'', Be-për drejtësi për të miturit dhe fëmijët'', të financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga UNICEF për mbeshtetjen e përpjekjeve reformuese të qeverisë për të siguruar që sistemi i drejtësisë t'i mbrojë të drejtat e të gjithë fëmijëve që bien në kontakt me ligjin.

5.5. Statistika rreth studime rastesh

Tabela 1.Forma e vendosjes së fëmijëve nën kujdestari nga viti 2017-2021[91]

	2017	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**
Fëmijë pa prindër dhe pa kujdesje prindërore	125	80	63	68	63
Fëmijë i mitur nën kujdestari	98	45	49	49	63
Bartës i përkujdesjes familjare	9	9	10	10	8
Bartës i përkujdesjes prindërore		0	1	1	1
Vendosje ne institucion					
IP Shtëpi për të mitur dhe fëmijë të vegjël në Manastir	3	7	1	3	3
IP Shtëpi e fëmijeve 11 Tetori	5	5	2	2	2
Kujdestari në tjetër familje					
Vendosje në familje përkujdesëse			0	0	19
Perkujdesje familjare			0	0	3
Të jetuarit me mbështetje					
OE SOS Fshati për fëmijë			0	2	2

Kjo tabelë pasqyron vendosjen e fëmijeve nën kujdestari, duke u bazuar sipas të dhënave statistikore nga viti 2017 deri më vitin 2021.

Siç mund të shohim, numri më i lartë i fëmijëve të mbetur pa prindër dhe pa kujdes prindëror është gjatë viteve 2017 dhe 2018,kurse duke filluar nga vitet 2018-2021, fillon të bie numri i fëmijëve të mbetur pa kujdes prindëror.

[91] Statistika nga Qendra për Punë Sociale , Kumanovë, nr.arhivues : 0302-191/1, 14.02.2023

Numri i vendosjes së fëmijëve të mitur nën kujdestari duke filluar në vitin 2017 dhe 2018 është i njejtë,prej gjithsej 98 , kurse e njejta duke filluar prej vitit 2019-2021 fillon të bie nga 45-63 fëmijë.Këta fëmijë ishin nën kujdesin e bartësve familjarë varsisht nga vitet duke filluar nga 9 deri në 10 bartës të përkujdesit.Kurse bartës të kujdesit prindëror vetëm nga 1 në vitin 2020 dhe 2021.

Po ashtu, në institucionin IP Shtëpi për foshnja dhe fëmijë të vegjël në Manastir në vitin 2017 ishin të vendosur 3 fëmijë ;2018-7 fëmijë ; 2018-7 fëmijë ; 2019-1 fëmijë ;2020-3 fëmijë ;2021 3 fëmijë, IP Shtëpi e fëmijëve 11 Tetori gjatë vitit 2017-5 fëmijë ; 2018-5 fëmijë ; 2019-2 ;2020-2 ; 2021-2 fmijë.

Numri fëmijëve të përkujdesur në familje tjetër gjatë 2021 ishte gjithsej 19, kurse në përkujdesje familjare gjatë vitit 2021 ishin të vendosur 3 fëmi. Ndërsa fëmijë të cilët jetonin me mbështetje në vitin 2021 dhe 2022 ishin nga dy fëmijë.

Tabela 2.Vendosja e fëmijëve në institucione[92]

OE SOS fshati për fëmijë Shkup	3- fëmijë te kujdestri
IP Shtëpi për foshnja dhe fëmijë të mitur në Manastir	3- fëmijë
IP Shtëpi për fëmijë ‘’11 Terori’’ Shkup	2 –fëmijë
IP për fëmijë me probleme sociale-edukuese	1-fëmijë
Qendër për trafikim me njerëz në Shup	1-fëmijë

Tabela përshkruan vendosjen e fëmijëve në institucione : në institucionin OE SOS fashati për fëmijë gjithsej nën kujdes janë të vendosur 3 fëmijë ; pastaj në IP shtëpi për foshnja dhe fëmijë të mitur në Manastir, gjithsej janë të vendosur 3 fëmijë ; në Institucionin Privat shtëpi për fëmijë 11 Tetori, Shup, gjithsej janë të vendosur 2 fëmijë ; në Instutcionin për fëmijë me probleme sociael-edukuese është i vendosur 1 fëmijë si dhe në Qendrën për trafikim me njerëz në Shkup është vendosur 1 fëmijë.

[92] Qendra për Punë Sociale, Kumanovë, nr.arhivues : 0302-191/1, 14.02.2023

Fotografia nr.3



Kjo fotografi e nxjerrë në bazë të raportit vjetor 2021, të Avokatit të Popullit, në bazë të parashtresave të praqitura në disa fusha i referohen mbrojtjes së të drejtave të fëmijeve 47.5% , në mbrojtjen sociale 34.2%, mbrojtja shëndetësore 15.0%, personat me aftësi të kufizuara 3.4%. Mund të konstatojmë që të drejtat në disa prej fushave nuk janë realizuar mjaftueshëm si në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen sociale, por realizimi i të drejtave ndaj personave me aftësi të kufizuara është dukshëm në nivel shumë të dobet.[93]

Gjithashtu do të prezantoj edhe vendosjen nën kujdestari tëa fëmijëve edhe në bazë të përkatësisë nacionale, gjinisë dhe numrit gjatë vitit 2021: [94]

[93] Raport vjetor nga Avokati i Popullit, (2021), https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2021/GI-2021-%20Alb.pdf

[94] Statistika të marrura nga Qendra për Punë Sociale Kumanovë, nr.0302-191/1, 14.02.2023

Përkatesia nacionale : Maqedon-34, Shqiptarë- 6, dhe Romë - 23.

Gjinia : femërore -37 fëmije ; mashkullore -26 fëmijë.

Mosha: i sapolindur -1 fëmij, 2 vjeç-1 fëmij, 3 vjeç-3 fëmijë, 4 vjet -2 fëmijë, 5 vjeç-1 fëmij, 6 vjeç-3 fëmijë, 8 vjeç-3 fëmijë, 9 vjeç - 5 fëmijë, 10 vjeç - 7 fëmijë, 11 vjeç - 3 fëmijë, 12 vjeç - 3 fëmijë, 13 vjeç - 6 fëmijë, 14 vjeç - 6 fëmije, 15 vjeç-3 fëmijë, 16 vjeç-5 fëmijë, 17 vjeç-10 femijë, 18 vjeç- 1 femijë.

5.6. Roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Institucioni i Avokatit të Popullit duke u mbështetur në parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe akteve juridike ndërkombëtare mbron të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kryerjen e detyrimeve të tij si institucion i pamvarur, i mëvëtesishëm dhe profesionalitetit të tij udhëhiqet nga parimet e objektivitetit, paanshmërisë si dhe ndershmërisë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarëve, pavarësisht përkatesisë kombëtare, bindjes fetare, gjinisë, racës etj.[95]Pas sjelljes së Ligjit të Avokatit të Popullit themelohet institucioni i Avokatit të Popullit, institucion i cili është themeluar në bazë të kushtetutshmëriisë dhe ligjit në vitin (1991).

Në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave të tij roli dhe funksioni i institucionit në sferën e të drejtave të fëmijeve është që të mbroj të drejtat e fëmijëve kur po të njejtat u shkelen nga ana organeve të administratës shtetërore, ose organeve tjera ekzistuese tjera me autorizime publike.[96]

Për më tepër, Avokati i Popullit, si organ i cili mbron të drejtat e njeriut dhe qytetarëve në përgjithësi, të cilat janë të garantuara me kushtetutë, ligje dhe dokumentet ndërkombëtare, përmes Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve dhe personave me pengesa në zhvillim bën mbrojtje të posaçme të të drejtave të fëmijëve me përfshirje të gjëre dhe aktive. Përpos, parashtresave (ankesave) të inicuara deri tek organi perkatës në lidhje me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, organi në kontinuitet vëzhgon gjendjen e institucioneve përgjegjëse si dhe respektimin e realizimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi nga organet gjegjëse përmes hulumtimeve për punën të cilën e kryejnë institucionet, ku pas vlerësimit nxirren konluzione dhe rekomandime ndaj po këtyre institucioneve.[97] Në rast vërtetimi të shkeljes së ndonjë të drejte, veprimi i Avokatit të Popullit është në dërgimin e rekomandimeve, sugjerimeve, dhe mendimeve se si vihet deri tek zgjidhja e problemeve konkrete e si të shmangen lëshimet e bëra nga institucionet, me qëllim që të drejtat e fëmijeve të realizohen në mënyrën sa më të duhur.

[95] Institucioni i avokatit të Popullit, www.ombudsman.mk
[96] Të dhëna të punuara nga instituti i Avokatit të popullit, www.ombudsman.mk
[97] Të dhëna të punuara nga institucioni i Avokatit të popullit, www.ombudsman.mk

Që nga momenti i miratimit të Ligjit për Avokatin e Popullit i cili u vu në funksion në vitin 2003, me këtë u përforcua roli institucionit dhe u ripërpunua procedura para institucionit. Si rezultat i këtij ligji ndikoi që fëmijët të konsiderohen si kategori e veçantë, me çka parashtresat fëmijët tani më mund ti inicojnë në mënyre individuale pa qenë nevoja për tu inicuar nga ana e prindit apo kujdestarit.

Tabela 1. Pasqyrë e parashtresave të pranuara në sferën e të drejtave të fëmijëve në zyrën e Avokatit të Popullit prej vitit 2018-2022.

Viti raportues	2018	2019	2020	2021	2022
nr.parashtresave	153	246	111	254	252

Tablela më lart ilustron gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve, të parashtruara pranë zyres së Avokatit të Popullit duke fillaur nga viti 2018-2022. Numri i parashtresave të pranura nga viti 2018 deri më 2021 ishte më i vogël duke filluar prej 153 parashtresave, krahasuar me vitet tjera viti 2021 dhe 2022 kishte dukshëm më shumë parashtresa 254 prej tyre të inicura. Vlersuar nga analiza e bërë, kjo dëshmon shkeljen e të drejtava të fëmijëve edhe më shumë.

Sipas të dhënave dhe vlerësimeve të marra nga instituti i Avokatit të Popullit, numri më i madh mbi shkeljen e të drejtave në sferën e të drejtave të fëmijëve, në krahasim me fushat tjera, konsiderueshëm ishte më i madh dhe paraqiste shqetësim.

Dëshmi mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ishin parashtresat e drejtuara tek Avokati i Popullit, e posaçërisht ata që kishin të bënin për mbrojtjen e të drejtës me kontaktin direkt të fëmijës me prindërit (në rast divorcimi të bashkëshortëve si dhe ndarjes së partnerëve jashtëmartesore), e drejta e arsimit, mbrojtja nga diskriminimi, të drejtat në të holla, e drejta për

mbrojtje shendetësore.[98] Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Avokati i Popullit siguron mbrojtjen e të gjitha të drejtave, e në veçanti:

1. të drejtat e fëmijëve në realizimin e të drejtave prindërore
2. të drejtat e fëmijëve që realizohen në kuadër të mbrojtjes shoqërore
3. të drejtat e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdesje prindërore
4. të drejtat e fëmijëve në sferën e arsimit
5. të drejtat e fëmijëve në sferën e punësimit në drejtim të ndalesës së punësimit nën moshën 15 vjeçare, si dhe të mbrojtes së posaçme të fëmijëve nën moshën 15 vjeçare
6. të drejtat e fëmijëve që realizohen në sferën shendetësore
7. të drejtat e fëmijëve në drejtim të fitimit dhe humbjes së shtetësisë së RMV-së
8. të drejtat e fëmijëve në sferën e sigurimit pensional dhe invalidor
9. të drejtat e fëmijëve ne raste të veprimit të Ministrisë së Punëve të Brendëshme, gjegjësisht personave zyrtarë në polici dhe organeve të tjera në drejtim të së drejtës së tyre. [99]

Kur flasim për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit konstatoi se mungojnë të dhëna të plota për kategorinë e personave të tillë, si dhe nuk ka as të dhëna rreth përgjegjësive prindërore pas shkurorëzimit përkatësisht ndërprerjes së bashkëjetesës, e njejta të sigurohet sipas Konventës së të Drejtave të fëmijëve, e cila obligon të dy prindërit në kujdesin e përbashkët të fëmijës së tyre. Më pastaj në drejtim të kësaj Avokati i Popullit, po ashtu rekomandoi të përgatiten statistika rreth përcaktimit të numrit të personave me aftësi të kufizuara, barrierat me të cilat ata ballafaqohen, përforcimin e kapaciteteve dhe nivelit të njohurive nëpërmjet të dhënave, duke u bazuar sipas gjendjes së aftësisë së tyre, moshës gjinisë përkatësisë etnike, fetare, etj.[100]

Duke analizuar në kontinuitet gjendjen e realizimit të të drejtave të fëmijëve, edhe përkundër vetëdijësimit të konsiderueshem mbi të drejtat e fëmijeve si dhe masave të ndërrmarrura nga ana e shtetit per realizimin e të drejtave tyre, prapë se prapë, Avokati i Popullit vie në përfundim se

[98] Të dhëna të punuara nga institucioni i Avokatit të popullit

[99] Të dhëna të punuara nga institucioni i Avokatit të Popullit

[100] Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, (2021), f.50., www.o,budsman.mk

në praktikë ende vazhon kjo gjendje mosrespektimi, që paraqet ngecje në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

5.7. Rezultate nga anketa mbi kujdestarinë e fëmijëve të mitur në RMV

Grafiku 1.



Grafiku lart, i shprehur në përqindje tregon njohuritë e anketueve për Ligjin Familjar të RMV-së i cili rregullon të drejtat e fëmijëve.

Nga pyetja e bërë të anketuarve, se a janë të njoftuar rreth një ligji të tillë morëm përgjigje si më poshtë:

Siaps të dhënave të mbledhura 56% prej të anketuarve u përgjigjën negativisht, duke pohuar që ata nuk kanë njourri këtë ligj.Kurse, pjesa tjetër e të anketuarve gjithsej prej 44% , treguan që kanë njohuri mbi Ligjin për familje.

Grafiku 2.



Për të kuptuar më shumë rreth çështjes së fëmijëve të mitur, duke u bazuar nën kornizat ligjigjore, pytëm të anketuarit se ndaj cilve fëmijë mund të aplikohej vënia nën kujdestrari.

Nga të anketuarit morëm disa mendime përafërsisht të njejta, ku sipas tyre nën kujdestari mund të vihen fëmijët pa prindër ,prindërit e të cilëve kanë humbur të drejtën prindërore për shkaqe të ndryshme.Kurse, nga pjesa tjetër e të anketuarve u shprehën se mund të vendoseshin fëmijët pa prindër,fëmijët pa kujdes prindëror,fëmijët me prindërit të cilët e keqpërdorin të drejtën prindërore dhe fëmijët jetim.

Nga kjo rezuton, që këto masa aplikohen nga shteti,kundrejtj fëmijëve të cilëve u mohoet e drejta e kujdesit nga prindërit e tyre për arsye të ndryshme,ku si pasojë nuk mund tu ofrohet kujdesi dhe mbrojtja afër familjes së tyre.

Grafiku 3.



Siç mund të vërehet nga grafikoni në bazë të pytjes drejtuar të anketuarve, se kush e ushtron rolin e kujdestarit ndaj fëmijëve të mitur, ata u përgjigjën duke thënë që këtë detyrim e mbart Qendra për Punë Sociale ose ndonjë familjar, në vijim, gjithashtu ishin të mendimit që këtë obligim mund të ushtroj edhe ndonjë person të cilin e cakton Organi i Kujdestarisë.

Mirëpo, nuk mungonte edhe mendimi prej të anketuarve që të njejtin obligim mund ta ushtrojnë edhe Jetimoret si dhe çiftet të cilët marrin nën përkujdesje për një kohë të caktuar deri në moshën madhore.

Grafiku 4.



Nga pyetja e radhës morem mendimin e të anketuarve se sa ishin të njoftur rreth mbrojtjes së fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror, duke pasë parasyshë që fëmijët në raste të tilla janë

më të pambrojtur, pashkak miturisë së tyre dhe pamundësisë për të mbrojtur të drejtat dhe interest e tyre.

Siapas përgjigjeve të të anktuarve rezultoi që 31% prej tyre ishin të njoftuar rreth mbrojtjes të së drejtave të fëmijëve , gjithashtu 31% prej pjesës tjetër të të aketuarve pohuan që mesatarisht kishin njohuri.Krahasuar nga të tjerët, ishte surprizues numri i të anketuarve prej 38% ,të cilët nuk kishin njohuri fare.Mosnjohuria e të drejave elementare të tyre, sigurisht do të pamundësonte mbrojtjen e drejtë dhe efikase të fëmijëve në përgjithësi.

Grafiku 5.



Obligim i shtetit të RMV-së , nën suaza të kornizës ligjore dhe kompetencave të saj është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, pavarsisht rrethanave në në të cilat gjenden ata.Andaj nga kjo pyejtje drejtuar të anketuarve domim të dinim se RMV-ja a i plotëson këto stadarde të duhaura, në ofrimn e këtij shërbimi ndaj këtyre fëmijëve.

Siç mund të shohim nga grafikoni më lart, fatkeqësisht , 25% nga të anketuarit pohuan që RMV-ja nuk ka standardin dhe kapacitetin e duhur në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, çka don të thotë që nuk është e gatshme të ofroj siguri,veçantërisht kur është nevoja e mbrojtjes së fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror si dhe atyre të cilët kanë mbetur pa prindër.Kurse, 25% e të anketuarve treguan që RMV posedon një standard të duhur në ofrimin e kësaj mbrojtje.

Krahasuar nga të anketuarit e më parshëm, 50% e anketueve tjerë ishin indeferent ndaj kësaj çështje, nga çka nuk kishin njohuri aspak.

Grafiku 6.



Parim bazë për funsionimin e një shteti social dhe demokratik, është respektimi dhe realizimi i të drejtave, për mbrojtjen e një shoqërie dhe zhvillimin e mirqenë të fëmijëve.Andaj, shikuar nga ky prizëm, në bazë të hulumtimit të realizur mbi ushtrimin e përgjegjësisë së institucioneve

shtërore si dhe ligjit për famije, në ofrimin e sigurisë kundrejt fëmijëve të mitur, morëm këta përgjigje:

Në total prej 53% e të anketuarve, nuk ishin dakord që institucionet e ushtrojnë me përgjegjësi kujdestrinë si dhe nuk e zbatojnë ligjin për familje, i cili do të ndihmonte në realizimin qëllimit të kujdestarisë .Kurse, 23% nga të anketuarit menduan të kundërten, duke thënë që institucionet e kyzejnë me sukses këtë detyrë.Në anën tjetër 6 % prej tyre mendonin se kjo detyrë realizoht deri diku, çka nënkupton jo në mënyrë të plotë. Pjesa tjetër e të anketuarve prej 12% u shpreh që kjo detyrë ofrohej mesatarisht, çka don të thotë se nuk është e mjaftueshme.

Si dhe 6% prej të anketuarve ,nuk kishin dijeni rreth kësaj çështje.

Grafiku 7.



Në grafikonim më lart, pyetëm të anketuarit, se Qendrat për Punë Sociale a kyejnë me përgjegjësi obligimin, kryesisht të kujdesurit ndaj fëmijëve të cilët janë të vendosur nën kujdestari.

Pothuajse të gjithë të anketuarit u përgjigjën negativisht , 94% prej tyre , duke thënë se organet të cilët janë përgjgjës në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, këtë obligim e kryejnë në mënyrë të pamajftueshme.Çka nënkupton se ajo nuk i aplikon masat e duhura në mbrojtjen e fëmijëve.Kurse pjesa tjetër e të anktuarve prej 6%, u përgjigjën duke thënë se

mjaftueshëm janë të përgjegjëm në kryerjen e obligimit të tyre, megjithatë në karahasim me të tjerët kjo është nën minimalen.

Grafiku 8.



Nga pyetja e rradhës donim të merrnim mendimin e anketuesve se sipas tyre në mungesë të prindërve, për t'u kujdesur për interesin më të mire të fëmijës, cila ishte alternativë më më e mirë.

Sipas të dhënave të marrurra prej anktuesve, vetëm 15% deklaruan që familja ishte forma e vetme e kujdesit ndaj tyre.Ata u shprehën që familja do të ishte forma më e duhur e kujdesit ndaj

fëmijëve të tyre, pasi që vetëm aty do të mundnin të merrnin kujdesin,dashurinë dhe ngrohtësinë e duhur, e cila do tu ndihmonte në zhvillimin e tyre.

Siç vijon më tej 23 % nga të anketuarit, u pajtuan që kujdestira ishte forma e vetme e kujdesit ndaj fëmijeve.Kurse, 54% nga të mbeturit treguan që kujdestaria nuk mund të jetë alternativë e vetme ndaj fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror, mund të kërkohet edhe zgjidhje tjetër duke u kujdesur nga më të afërmit e tyre po të jetë mundësia.Kurse 8% prej të anketuave menduan që kjo përgjësi do tu takonke edhe institucioneve përkujdesëse,patjetër që për raste më specifike do të ishte e nevojshme edhe aparati shtetërorë të kontribuoj në mbrojtjen e fëmijëve.

Grafiku 9.



Në bazë të analizës së bërë përmes kësaj pyetje, qëllimi ynë ishte të mernim informacion se për kujdestar për fëmijët e mitur do të ishte më mirë të caktohej ndonjë anëtar i familjes apo Qendra për Punë Sociale.

Sipas të anketuarve , 94% prej tyre dhanë mendimin që vetëm anëtari i familjes ishte zgjidhja më e duhur për tu kujdesur për fëmijën. Kjo bënë të kuptojmë që vetëm afër ambienti familjar do mund ti plotësonte të gjitha parakushtet dhe nevojat e duhura për një fëmijëri të denjtë dhe të lumur, kurse 6 % prej tyre mendonin që këtë deyrim duhej ta kishte Qendra për Punë Sociale që ishte dukshëm në numër më i vogël, kujdesi I tillë mund të aplikohet vetëm si alterantivë e fundit.

Grafiku 10.



Përgjatë procesit të hulumtimit, vërtetuam se të kujdesurit ndaj fëmijëve të mitur nga ana e kujdestarit, është pjesë e përgjesisë si tij, i cili duhej të kujdesej për ata sit ë ishte prindi i tyre si dhe të mbronjë të drejtat dhe interesta e tyre.Andaj, në këtë rast pyetëm të anketuarit se a kanë hasur ndonjëherë në kepërdorimin e fëmijëve nga ana e kujdestarit.

Nga 75% të anketuarve treguan që nuk kanë parë ndonjë rast të kepërdorimit të fëmijëve nga kujdestari, gjë të do të ndikonte pozitivisht në edukimin, socializimin dhe mireqenien e fëmijëve.Kurse pjea tjetër e të anketuarve prej 25% treguan që kanë pare raste të keqpërdorimit

të fëmijëve nga kujdestarët.Lind pyetja këtu, a duhet të jetë shqetësues ky fakt dhe se qytetarët në këtë rast a janë të gatshëm të paraqesin këtë rast apo zgjedhin ta heshtin një gjë të tillë.

Sigurisht se duhet marrur hapi për paraqitjen e rastit në instancat përgjegjëse shtetërore dhe patjetër që rasti në fjalë duhet trajtuar.

Grafiku 11.



Nga grafikoni më lart, pyetëm të anketuarit se si do të kishte ndikuar po të kompensohej në të holla pununa e kujdestarit, më konkretisht a do ta kyenin me më përgjegjësi dhe ndërgjegje obligimn e tyre kujdestarët?

Nga të anketuarit 69% prej tyre pohuan që të shpërblyerit e punës së tyre, do të ndikonte në ushtrimin më të mirë të obligimit të tyre ndaj fëmijëve. Me siguri se ndoshta do ta motivonte në kyerjen e këtij obligimi, megjithatë parap ngelet tek ndërgjegjja e tij duke pasur parasysh gjendjen e fëmijëve në atë rast.

Kurse, 31 % prej tjerëve menduan që kjo nuk do të bënte ndonjë ndryshim që dukshëm ishte numri më i voglël.

Grafiku12.



Për në fund, duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe pa kujdesje prindërore si dhe për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh statusit të tyre,

pyetëm të anketuarit, se fëmijët a e marrnin kujdesin e duhur nga ana institucioneve përgjegjëse shtetërore.

Nga hulumtimi I realizuar, nuk pritej të kishte kaq shumë pakënaqësi të lartë për kujdesjen e fëmijëve të mitur nga ana e institucioneve.Por, patjetër që 88% prej të anketuarve tregun që ky kujdes nuk ofrohet nga ana e institucioneve përgjegjese.Kurse, 12% prej të anketuarve u shprehën që kujdesi ndaj fëmijëve të mitur pa kujdes prindëror, ofrohej nga ana e insitucioneve përgjëse.

6.Konkluzion

Mund të konlkudohet që korniza ligjore në RMV, për kujdestarinë e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror është përfshirë në legjilsacionin familjar të këtij vendi dhe kësaj shoqërie. Ky teskt ligjor prezenton të drejtat fundamentale rreth të drejtave, detyrimeve dhe interesave të fëmijëve minoren. Zbatimi i këtyre ligjeve ngelet cështje për të punuar me një dinamikë dhe vullnet më serioz nga ana e institucioneve publike, po ashtu dhe shoqëria. Për më shumë Konventa për të drejtat e fëmijëve, vetëm që thekson dhe nënvizon më tepër rendësin e të drejtave bazike të fëmijëve, ku RMV është nënshkruese e saj.

Duke u nisur nga pjesa e hulumtimit në teren, leximet për cështjen përkatëse mbi të drejtat dhe interesat e fëmijëve minoren, mbledhjen e statistikave nga Qendra për Punë Sociale dhe nga Avokati i i Popullit, qasjen jo mjaftueshëm bashkëpunuese nga ana e institucioneve atë që vë re dhe konstatoj është se mungon thellësisht një kapacitet institucional për tu pëballur me nevojat reale për këta fëmijë. Dihet se fëmijët janë qeniet më të pambrojtura, u mungon pjekuria psikologjike dhe eomcionale për të qenë të ushtrues të vetëdijshëm të së drejtave dhe interesave të tyre. Pikërisht për këtë duhet që ligji të aplikohet plotësisht, e jo të jetë gjysmak zbatimi. Qendra për Punë Socaile dhe Avokati i Popullit, kanë pjesërisht kompetencat për plotshmërinë e zbatimit të ligjit mbi të drejtat dhe interesave të fëmijëve. Ajo që është e dukshme është se edhe në këtë komptencë parciale ka mungesë të standardit dhe kapacitetit institucional.

Shoqëria ngelet një aktor pasiv dhe ishte befasues sa ishin indiferentë për ditur rreth ligjit që mbron fëmijët.

Si përfundim, të drejtat dhe interesat e fëmijëve ngelen të pambrojtura nga ana e institucioneve shtetërore, si garantues të po të njejtës.

7.Rekomandime

Nga hulumtimi i bërë, konstatuam që Ligji për familje me dispozitat e saj u siguron mbrojtje të veçant të drejtave të fëmijëve, e sidomos fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror, megjithatë në praktikë nuk përmbushet plotësisht ky obligim nga Institucionet përgjegjëse.Andaj, rekomandojmë që Qendra për Punë Sociale si dhe institucionet përgjegjëse të punojnë me seriozitet në ngritjen e kapaciteteve dhe shërbimve të tyre në mbrojtjen e fëmijëve, të përdorin të gjitha masat e nevojshme edhe në praktikë , kur dyshohet rreziku nga keqtrajtimi i të drejtave të fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve si dhe edukimi i fëmijëve të vendosur në format e ndryshme insitucionale, ndikon në zhvillimin e mirqenë të tyre, për këtë arsye rekomandojmë që monitorimi i gjendjes së tyre dhe dhënia e këtij shërbimimi në këto institucione të ofrohet në mënyrën sa më të mirë dhe më efikase, tu sigurohen kushte dhe standarde për një jetë më cilësore.

Pa dyshim se roli i Kujdestarit në mbrojtjen e personalitetit dhe interesave të fëmijëve është i rëndësishëm, andaj rekomandojmë që kujdestarët, ekipet profesional, pedagogët dhe psikologët të trajnohen në mënyrë të veçant, që në të ardhmen të jenë të përgatitur për ta kryer obligimin e tyre në mënyrë profesionale dhe me ndërgjegje të plotë, për zhvillimin e mirqenë të fëmijëve.

Gjatë hulumtimit vërtetuam se alternativë më e mirë për një mirëqenie më e mirë të fëmijëve , do të ishte të jetuarit e fëmijëve, afër familjes së tyre, në këtë rast rekomandojme që shteti me kapacitetet e saja t'i ofrojë mbrojtje familjes qoftë ajo ekonomilke, sociale apo morale, në të kundërtën vendosja ninstitucione e fëmijëve të aplikohet vetëm si aternativë e fundit.

Rekomandojmë që shteti si dhe organizatat joqeveriate ,të punojnë dhe të krijojnë aktivitete në vedijsimin e shoqërisë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Pasi që shoqëria gjithashtu nuk është e njoftuar mbi dukurinë e trafikimit të fëmijëve si dhe mbi fëmijët me aftësi të kufizura, si pjesë e shoqërisë , sugjerojmë që ata të njoftohen me këtë dukuri si problem, i cili do tu ndihmonte në mbrojtjen më të mirë të fëmijëve të tyre.

8.Bibliografia

-Zendeli, E., Selmani-Balkiu, A., Mickoviq, D., Ristov, A. " *E drejta familjar*e" Tetove,Qershor 2020

-Spiroviq-Terpenovska, L., Mickoviq, D.,Ristov,A. " *E drejta familjare*"Shkup, 2013.Arifi, B., Retkoceri,V., Selmani-Bakiu,A.,Metaj-Stojanova,A.,Ibish,E."*Te drejtat e femijeve: Sfidat dhe perpjekjet e reja*"Tetove,2022

-The Rights of the Child and their protection, Project"Harmonisation of the Law of the Republic of North Macedonia with the law of the Europena Union" 20 November (2020) , ISBN:9786082032962, COBISS.MK-ID:51229445

-Selmani- Bakiu, A., Mickoviq D., *"Parental Responsibility after Divorce: the Case of North Macedonia"*, International Journal of Law, Policy and the Family, Volume 35, Issue 1, 21.06. 2021.

-Kosher, H., Ben, A., Hendelsman , A., (2016), NeW York, NY USA, ISSN: 2195-9757 (electronic), ISBN : 978-3-319-43918-1

-Drozd L., Saini M., Olsen N., "*Parenting Plan Evaluations: Applied Research for the Family Court"*, Oxford university, ISBN: 9780190463182

-Melo I., " *Sherbimi i kujdestarisë ndaj të miturve jashtë kujdesit prindëror dhe roli i shtetit shqiptar"* , Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009. Mickoviq D., Ristov A., "*Family Law in the Civil Code of the Republic of Macedonia"* Journal of Civil & Legal Sciences, 06.01.2016.

-Mickoviq D., Ristov A., *"Parenting after dirvorce in Macedonian Family Law "*, Comparative Review of the Legislation in the Republic of Macedonia and the Convention on the Rights of the Child, UNICEF, Ministry of Justice, Skopje, 2010 p. 104-112.

-Elena I., *"The Family Law of the Republic of North Macedonia through the prism of the European Convention on Human Rights"*,

-Sutova M., "Application of article 12 of the Convention on the rights of the child in judicial proceedings in Republic of North Macedonia", Legal Studies ISSN ISBN: 978-608-66152-4-6, 03.02.2020.

-Dwyer J., "Family Law: Theoretical Scientific and Comparative Perspectives", ISBN-13: 978-145481366

-Robert M., Galatzer- Levy J., Kaus L., "*The Scientific Basis of Child Custody Decisions"*, ISBN-13: 978-047003858

-Evert C., "*Child Custody Legal Decisions and Family Outcomes",* Routledge Press, ISBN 9781138012264, 09.02.2015.

-Philip M., "*Conducting Child Custody Evaluations: From Basic to Complex Issues", SAGE Publications*, 01.18.2013.

-UNICEF, Report "Situational analysis of the Rights of Persons with Disabilities in the Repblic of North Macedonia"2021, United Nations publication issued by the United Nations in North Macedonia,December 2022, https://www.undp.org/north-macedonia/publications/situational-analysis-rights-persons-disabilities-republic-north-macedonia-2021

-''Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise'', nr.153 nga 20.10.2014

-Pergjigje te marrura ne baze te pyetesorit te marre nga Qendra per Pune Sociale

-Convention on the Right of the child, https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child, 20 September 1990

-"Raporti Vjetor i Avokatit te Popullit per nivelin e respektimit, avancimit dhe mbrojtjes se lirive dhe te drejtave te njeriut", Mars, (2021), Shkup, www.ombudsman.mk

-Statistika nga Qendra per Pune Sociale, Kumanovë, 14.02.2023, www.jumcsrkumanovo.com.mk

-"Извештај од спроведеното истражување за појавите на злоупотребата и сексуална експлоатација на деца " Скопје 2012, www.ombudsman.mk

-Rapport "Informata per dukurine e trafikimit me femije ne Republiken e Maqedonise " , Shkup 26.10.2010, www.ombudsman.mk

-Elias Beck," Child labour in Industrial revulution "December 30.2016, Elias Beck,", https://www.historycrunch.com/child-labor-in-the-industrial-revolution.html#/

-"Using the Human rights freamwork to promote the rights of children with disabilities": Disscusion Paper An analysis of the Synergies between CRC,CRPD and CEDAW

-"childrens rights an interdisciplinary introduction ", 2022, University of Geneva, -www.cursera.org

-Institucione për mbrojtje sociale -www.mtsp.gov.mk

-Children's rights, https://www.coe.int/en/web/children

-Parental responsibility-child custody and contact right, https://e-justice.europa.eu/302/EN/parental_responsibility__child_custody_and_contact_rights?SPAIN&member=1

-Report ''Guardianship systems for unaccompanied children in the Europenan Union'' -Developments since 2014, (2022), Publications of the European Union, ISBN: 978-92-9461-455-1, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2022-guardianship-systems-developments_en.pdf

Ligji për familje, („Gayeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006,84/2008,67/10,156/10,39/12,44/12,38/14 dhe 115/14), https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/5.11_Закон%20за%20семејството%20(консолидиран%20текст%20ноември%202015).pdf

- Using the human rights framework to promote the rights of children with disabilities:Discussion Paper, An analysis of synergies between CRC,CRPD AND CEDAW, https://www.unicef.org/media/126396/file/Synergies-paper-Web.pdf

Parental responsibility-child custody and contact right, https://ejustice.europa.eu/302/EN/parental_responsibility__child_custody_and_contact_rights?BELGIUM&member=1

-Kushtetuta e RM ,https://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx , nr. 08-4642/1, 17 Nëntor 1991,Shkup

-Ligji për familjen i RM-së, - ("Gazeta zzrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.80/92,9/96,38/2004,33/2006,84/2008,67/10,156/10,39/12,44/12,38/14,115/14,149/99,79/2001, 60/2005,2/2009,117/2009), www.pravdiko.mk

Ligji për procedurë jashtëkontestimore i RM-së, https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-vonparnichna-postapka , Објавено во Сл. Весник на РМ, бр.09 од 18.01.2008 година

Ministria për punë dhe politikë sociale, https://mtsp.gov.mk/